

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5480  
E shtunë, 19 maj 2018  
çmimi 0.40 €

Thaçi: Faza finale e dialogut  
do të jetë e vështirë  
dhe me të panjohura FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## AKTUALE

**NAFTA VAZHDON  
TA RROKULLISË  
BOTËN** F. 11



SHKRUAN:  
AGRON HOTI

**PIETRO SPERA, AVOKAT I  
DHOMAVE TË SPECIALIZUARA** F. 2

**VESELI PREMTON  
QASJE MË PROGRESIVE  
PËR DIASPORËN** F. 6

## EKONOMI

**HARADINAJ NË FORUMIN  
EKONOMIK TË VJENËS:  
KOSOVA, E HAPUR  
PËR INVESTIME** F. 9

**RRITET ÇMIMI I DERIVATEVE  
EDHE NË KOSOVË** F. 8

## KULTURË

**E VËRTETA QË PROTESTON  
NËPËR QIELL** F. 7

DIJE DEMIRI-FRANGU

**POETIKA E KLITHMËS  
ATDHETARE** F. 7

Behar GJOKA

## SPORT

**VËLLAZNIMI E GJILANI,  
'LUFTË' PËR T'I IKUR  
BARAZHIT** F. 18

**FEDERATA E SKITARISË E  
KOSOVËS PRANOHEM ME TË  
DREJTA TË PLOTA NË FIS** F. 18

FLET PËR "EPOKËN E RE", ENVER HOTI FAQE 4-5

## Ligji për Qeverinë duhet të bëhet sa më shpejt

Deputeti i Nismës Socialdemokrate, Enver Hoti, ka thënë se është e nevojshme të bëhet sa më shpejt Ligji për Qeverinë, në mënyrë që të mos ketë shpenzime enorme, qoftë edhe në aspektin e numrit të madh të zëvendësministrave. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoti ka folur edhe për qeverisjen në vend. Ai ka thënë se kjo Qeveri ka pasur një sërë aktivitetesh që kanë ndikuar në zhvillimin ekonomik, në mirëqenien sociale dhe në atë shëndetësore. Hoti ka theksuar se përpjekjet që janë ndërmarë në këtë Qeveri kanë sjellë zhvillime pozitive në vend. Ai ka lavdëruar punën e tre ministrave të Nismës Socialdemokrate që janë pjesë e Qeverisë Haradinaj. Deputeti Hoti ka bërë thirrje për një qasje më të kujdesshme për ndërmarrjet publike, duke pohuar se në këtë gjendje nuk bën të shkojnë në procesin e privatizimit dhe as të kolapsit

## Njohësit e sigurisë: Ushtria të bëhet përmes ligjit

FAQE 7

Njohësit e sigurisë, Ramadan Qehaja dhe Kadri Kastrati, kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se Kosova nuk duhet të vonohet për transformimin e FSK-së në ushtri. Sipas tyre, Kosova nuk

mund të presë në pafundësi që Lista Serbe ta ndryshojë qëndrimin sa i përket formimit të ushtrisë. Qehaja dhe Kastrati kanë thënë se meqë Lista Serbe heziton t'i votojë ndryshimet kushtetuese,

atëherë duhet të shkohet me planin 'B', që ushtria e Kosovës të formohet përmes ligjit, por për këtë iniciativë duke ia shpjeguar arsyen faktorit ndërkombëtar dhe miqve amerikanë

## Mbahet testi i arritshmërisë për klasat e nënta

27 mijë nxënës në të gjithë Kosovën i janë nënshtruar të premten testit të arritshmërisë. Ky test përmban 100 pyetje nga lëndët gjuhë shqipe,

matematikë, gjuhë angleze, kimi, fizikë, gjeografi, histori, informatikë dhe ka për qëllim orientimin e nxënësve për shkollimin e mëtejshëm FAQE 6

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**SatStyro**  
Mushnikovë-Prizren-Kosovë  
Product of EPS and XPS  
Mob.: +377(0) 44 506 815  
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030  
e-mail: [sat\\_styro@yahoo.com](mailto:sat_styro@yahoo.com)  
[www.satstyro.com](http://www.satstyro.com)

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# Pietro Spera, avokat i Dhomave të Specializuara

Të premtën italiانى Pietro Spera është emëruar Avokat i Popullit i Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Spera ka një përvojë pune 30-vjeçare, ligjore e gjyqësore, në veçanti për mbrojtjen e të drejtave në procedurat gjyqësore

**HAGË, 18 MAJ** - Italiانى Pietro Spera është emëruar Avokat i Popullit i Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Në një njoftim nga Zyra për Media e Dhomave të Specializuara, thuhet se Spera ka një përvojë pune 30-vjeçare, ligjore e gjyqësore, në veçanti për mbrojtjen e të drejtave në procedurat gjyqësore.

Spera, thuhet në komunikatë, ka punuar gjykatës ndërkombëtar në Dhomën për Krime Luftë dhe Krimin e Organizuar të Gjykatës Shtetërore të Bosnjë e Hercegovinës dhe në Afganistan, ku ka kryesuar disa projekte për fuqizimin e sundimit të ligjit në sistemin gjyqësor të Afganistanit. Me rastin e emërimit në këtë detyrë, vetë avokati Spera ka thënë se është i gatshëm për sfidën e përmbushjes së man-

datit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. "Avokati i Popullit luan një rol thelbësor në monitorimin, mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore mishëruar në Kushtetutën e Kosovës të të gjithë personave që kanë punë me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Nga ana tjetër, Avokati i Popullit nuk mund të ndërhyjë në procedura gjyqësore të Dhomave të Specializuara, përveçse në rast të vonesave të paarsyeshme. Gjithashtu, Avokati i Popullit mund t'i paraqesë rekomandime kryetarit të Dhomave të Specializuara ose prokurorit të specializuar për çështje që janë pjesë e funksioneve të tyre", ka deklaruar Spera.

Edhe kryetarja e Dhomave të Specializuara, gjykatësja



Ekaterina Trendafilova, e ka mirëpritur emërimin e Spera. "Sot është një ditë e rëndësishme për Dhomat e Specializuara. Emërimi i Speras Avokat i Popullit shënon një moment tjetër kyç për institucionin tonë. Mandati dhe roli unik i Avokatit të Popullit e bëjnë atë garantues të të drejtave themelore të kujtdo

që ka punë me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, duke mundësuar përmbushjen e standardeve më të larta të të drejtave të njeriut", ka thënë ajo. Mandati i Gjykatës Speciale për krime luftë përkufizohet kryesisht në hetimet dhe gjykimet e rasteve të pretenduara të krimeve

të luftës nga ana e disa ish-pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndaj pjesëtarëve të komuniteteve pakicë dhe kundërshtarëve, që përfshin periudhën kohore nga viti 1998 e deri në fund të vitit 2000. Kjo gjykatë u krijua pas ndryshimeve kushtetuese nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2015.

## Limaj: Serbia të reflektojë, pavarësia e Kosovës është temë e mbyllur



**PRISHTINË, 18 MAJ** - Pavarësia e Kosovës është çështje e mbyllur dhe Serbia duhet ta pranojë këtë realitet. Kështu është shprehur zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, në konferencën e organizuar në Zagreb me temën "Përvoja e shteteve të Ballkanit në zgjidhjen paqësore të konflikteve".

Në këtë konferencë Limaj ka theksuar se Republika e Kosovës ka marrëdhënie shumë të mira me vendet fqinje dhe është e përkushtuar të ketë edhe me

Serbinë. "Është koha që edhe Serbia të luajë rol konstruktiv dhe ta pranojë realitetin e krijuar në Kosovë si parakusht dhe mundësi për rajonin që të ecë përpara. Çështja e pavarësisë së Kosovës është temë e mbyllur dhe këtë e di e gjithë bota. Është koha që edhe Beogradi të reflektojë dhe ta pranojë këtë realitet. Me këtë veprim vlerësoj se Beogradi do t'i ndihmonte edhe vetes", ka thënë Limaj. Ai ka theksuar se të drejtat e minoriteteve, përfshirë atë serb,

janë të garantuara në Republikën e Kosovës, por Serbia duhet të heqë dorë nga pretendimet territoriale. "Koha e pretendimeve territoriale dhe e shkëmbimeve të territoreve ka përfunduar. Janë teza të rrezikshme dhe as që duhet të konsiderohen si opsion. Këto teza kanë çuar në luftëra të përgjakshme në vitet e '90-ta. Koha është që të gjithë së bashku t'i japim mundësi rajonit që të integrohet në familjen e madhe evropiane", ka deklaruar zëvendëskryeministri Limaj.

## Opozita e bashkuar thërret protestë kombëtare në Tiranë

**TIRANË, 18 MAJ** - Pas mbledhjes me aleatët, Basha doli në një deklaratë për mediet, duke u bërë thirrje qytetarëve të bashkohen në protestë, për të cilën tha se do të mbahet më 26 maj në Tiranë. "Opozita e bashkuar i fton të gjithë qytetarët shqiptarë, demokratë e socialistë, të bashkohen në protestën më të madhe. Ju ftoj të protestojmë për largimin nga pushteti të kriminelëve. I ftoj qytetarët të protestojmë së bashku për largimin e Fatmir Xhafajt. I ftoj të protestojmë për largimin nga policia të atyre që ndihmojnë kriminelët si Agron Xhafaj, Habilajt, Balilajt. Ne do t'i

themi ndal procesit të zëvendësimit të kriminelëve që i shërbenin Tahirët me ata që i shërbejnë Xhafajt. Sot duhet të kemi një Ministri të Brendshme dhe një polici që u shërbejnë njerëzve. Jo një polici që rëmben në mes të natës Zaganin dhe kuksianët e pafajshëm, ndërkohë që i nënshtrohet Artan e Moisi Habilajt dhe Agron Xhafajt. Ne duam një polici ku vetingu të fillojë nga ministri i Brendshëm te polici më i thjeshtë. Ne i ftoj qytetarët për të protestuar për drejtësi të vërtetë dhe jo false. Për drejtësi të barabartë për të gjithë. Për drejtësi që nuk kursen

asnjë politikan. Të gjithë ne, pavarësisht cilës parti i përkasim, pavarësisht se ku jetojmë, pavarësisht se në çfarë besojmë, jemi në radhë të parë shqiptarë. Mbi të gjitha, e duam Shqipërinë. Një Shqipëri pa krim, një Shqipëri pa drogë. Një Shqipëri evropiane. Një Shqipëri ku ka mundësi dhe dinjitet për të gjithë. Tani është momenti të mos e shtyjmë më. Ne nuk mund të humbasim më kohën dhe energjitë tona çdo ditë duke u marrë me kriminelin e radhës në politikë. Është koha t'u themi sot ndal të gjithë politikanëve të lidhur me krimin", tha Basha.



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se po përgatitet faza finale e dialogut Kosovë - Serbi

# Thaçi: Faza finale e dialogut do të jetë e vështirë dhe me të panjohura

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se faza finale e dialogut me Serbinë do të fillojë shumë shpejt dhe pritet të përmbyllet brenda nëntë muajve. Pas kthimit nga Samiti i Sofjes, Thaçi në një konferencë me gazetarë ka thënë se kjo fazë e dialogut do të jetë jashtëzakonisht e vështirë për të dyja vendet por, sipas tij, kjo është alternativa e vetme për Kosovën dhe Serbinë. Shefi i shtetit ka vlerësuar se në këtë proces mund të ketë edhe të panjohura, por jo edhe befasi

**EPOKA  
ERE****Muahmet KOCI**

**PRISHTINË, 18 MAJ** - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka paralajmëruar se faza finale e dialogut me Serbinë do të jetë jashtëzakonisht e vështirë dhe me komplikime. Në një konferencë mbajtur me gazetarë të premtën, pas kthimit nga Samiti i Sofjes, ai ka treguar për zotimet që ka marrë Kosova për këtë proces nga liderët e BE-së. Shefi i shtetit ka thënë se ky proces, i cili pritet të përmbyllet brenda 9 muajve, mund të ketë edhe të panjohura. "Do të fillojë pas disa javësh dhe jam optimist se brenda një periudhe 9-mujore do të përmbyllet si marrëveshje. Po them përsëri se do të jetë një proces jashtëzakonisht i vështirë, me plot komplikime, mund të ketë edhe të panjohura, por nuk besoj se do të ketë befasi. Shpresë dhe optimizëm në këtë proces më jep përfshirja e fuqishme dhe unike e BE-së dhe mbështetja e ShBA-së", ka thënë Thaçi.

Ai ka vlerësuar se Kosova dhe Serbia nuk mund të mbesin pengje të së kaluarës dhe se të dyja vendet duhet të lëvizin përpara në agjendën evropiane. Sipas tij, të dy vendet në këtë proces duhet të mendojnë për gjeneratat e dekadave të ardhme dhe ta përmbyllin njëherë e përgjithmonë këtë raport konfliktuoz. "Do të jetë një proces shumë i vështirë për

Kosovën. Nuk do të jetë fare i lehtë as për Serbinë. Mund të them se do të jetë proces shumë i vështirë edhe për mua si president i vendit, sikurse nuk do të jetë i lehtë as për presidentin Vuçiq. Ne nuk mund të mbesim peng i së kaluarës e as i opinionëve ngufatëse për të lëvizur më shpejt në perspektivën evropiane. Ne duhet të mendojmë për të sotmen dhe të ardhmen. Jemi zotuar para përfaqësueses së lartë të BE-së, Federica Mogherini, më pas edhe para kancelares gjermane Angela Merkel, që të dy vendet të punojnë me përgjegjësi për ta përmbyllur këtë proces të dialogut me një marrëveshje historike, ligjërisht obligative për të dy vendet, e që do ta nënkuptojë anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe njohjet reciproke", ka thënë Thaçi, duke përmendur edhe porositë kryesore të liderëve të BE-së në samit. "Gjithashtu, një nga konkluzionet më të rëndësishme apo edhe qëndrim, mund të themi lirisht se na është dhënë në Samitin e Sofjes nga liderët e BE-së, është se pa fqinjësi të mirë asnjë vend i rajonit të Ballkanit nuk ka perspektivë evropiane", është shprehur Thaçi.

Presidenti ka përsëritur se në fazën finale të dialogut me Serbinë do të nevojitet që Kosova të ketë unitet të forcave politike e institucionale. "Koordinimi do të jetë shumë i



ngushtë me të gjithë dhe veç jam në koordinim dhe komunikim me shumicën e liderëve opozitarë. Po punojmë

bashkërisht që t'i shohim mundësitë më të mira se si t'i përgjigjemi kësaj sfide. Ky proces nuk është punë e një indivi-

di apo e një partie politike. Është proces historik dhe u takon njerëzve të Kosovës", ka thënë ai.

## Vendimi për viza, në muajin qershor

Presidenti Hashim Thaçi ka folur edhe për procesin e liberalizimit të vizave. Ai ka treguar se Komisioni Evropian vendimin pritet ta marrë në pjesën e dytë të qershorit. "Prej 95 kritereve të kërkuar nga ne për liberalizim të vizave, Kosova i ka zbatuar në tërësi. Prandaj, pres që gjatë pjesës së dytë të qershorit ta kemi deklarimin e Komisionit Evropian, pastaj ta kemi periudhën kohore të specifikuar, ku qytetarët e Kosovës gjatë këtij viti të lëvizin lirshëm", ka thënë ai. Sa i përket Samitit të Sofjes, presidenti ka thënë se ky samit

për Kosovën kishte një rëndësi të veçantë. "Ky samit ka të veçantën e vet, sepse Kosova për herë të parë në historinë e saj ka marrë pjesë në një samit të tillë. Prandaj, pjesëmarrja e Kosovës është historike. Është hera e parë që Kosova merr pjesë në një samit të këtij niveli si shtet i barabartë me të gjitha shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Ka qenë një fitore diplomatike për Kosovën dhe për të gjitha shtetet anëtare të BE-së, që e njohin Kosovën dhe të tjerët që janë në proces të njohjes", është shprehur presidenti, duke shtuar se për këtë Kosova i është mirënjohëse

kryeministrit bullgar dhe liderëve të shteteve anëtare të BE-së. Sipas tij, edhe në këtë samit është vërejtur mbështetja unike për Kosovën. "Është një mbështetje unike e liderëve të vende të BE-së dhe bartësve të institucioneve të saj për të arriturat në Kosovë. Interesimi i sinqertë i kancelares Merkel për Kosovën, por edhe për rajonin, u pa edhe një herë me hapin e saj konkret që të më bëjë bashkë në takim dhe bisedë edhe me presidentin serb Vuçiq, në të cilin takim u konfirmua edhe një herë përkushtimi ynë që ta fillojmë fazën finale të dialogut", ka thënë Thaçi.

## Khavit Haliti dhe Arben Gashi përplasen fizikisht në Kuvend



**PRISHTINË, 18 MAJ (ER)** - Një konflikt verbal i filluar të enjten në sallën e Kuvendit të Kosovës, në mes të deputetit të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Khavit Halitit, dhe atij të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Arben Gashit, ka degjeneruar në seancën e së premtes në përleshje fizike. Incidenti ka ndodhur kur deputetët po votonin për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese. Deputeti i PDK-së, Khavit Haliti, pasi ka dalë nga kabina e votimit me fletëvotim në dorë, ka shkuar

drejt vargut të deputetëve ku gjendej edhe Arben Gashi. Në momentin kur i është afruar, Haliti e ka shtyrë me bërryl deputetin e LDK-së. Menjëherë kanë ndërhyrë kolegët e tyre mes tyre, për të mos lejuar ndonjë përleshje. Pak sekonda më pas, deputeti i AAK-së, Gani Dreshaj, ka bërë një polemikë me deputetin Arben Gashi, të cilit ia ka drejtuar gishtin si formë e tërheqjes së vërejtjes. Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka reaguar ndaj kësaj situatë, duke theksuar se është e

papranueshme që deputetët e Kuvendit ta fyejnë njëri-tjetrin dhe të përleshen fizikisht. "Për më tepër, dhuna dhe konfrontimet fizike cenojnë rëndë vlerat të cilat do të duhej t'i përfaqësonte organi më i lartë në vend. Kuvendi i Kosovës, si institucioni më i lartë i shtetit, duhet të shërbejë si vend ku promovohen vlerat e demokracisë dhe të drejtat e njeriut, e jo të shndërrohet në arenë ku përplasjet dhe fyerjet janë normale", është thënë në reagimin e KDI-së.

Flet për "Epokën e re", Enver Hoti

# Ligji për Qeverinë duhet



Deputeti i Nismës Socialdemokrate, Enver Hoti, ka thënë se është e nevojshme të bëhet sa më shpejt Ligji për Qeverinë, në mënyrë që të mos ketë shpenzime enorme, qoftë edhe në aspektin e numrit të madh të zëvendësministrave. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoti ka folur edhe për qeverisjen në vend. Ai ka thënë se kjo Qeveri ka pasur një sërë aktivitete që kanë ndikuar në zhvillimin ekonomik, në mirëqenien sociale dhe në atë shëndetësore. Hoti ka theksuar se përpjekjet që janë ndërmarrë në këtë Qeveri kanë sjellë zhvillime pozitive në vend. Ai ka lavdëruar punën e tre ministrave të Nismës Socialdemokrate që janë pjesë e Qeverisë Haradinaj. Deputeti Hoti ka bërë thirrje për një qasje më të kujdesshme për ndërmarrjet publike, duke pohuar se në këtë gjendje nuk bën të shkojnë në procesin e privatizimit dhe as të kolapsit

izuar. Pra, disa nisma që kanë mbetur të përfunduar nga qeverisja Mustafa po përfundojnë. Të gjitha këto tentativa kanë sjellë zhvillime pozitive. Ka një ekonomi të tregut dhe tentativat për t'i parandaluar nga aktorë të ndryshëm proceset e dëmshme, pra nga aktorët e ndryshëm të cilët janë të vendosur për t'i ruajtur interesat dhe monopolët e veta. Mendoj se edhe reformat që janë marrë në sistemin e drejtësisë do t'i hapin një perspektivë të re zhvillimit ekonomik. Një ndër pengesat kryesore për zhvillimin e vendit është mosfunksionimi i sistemit të drejtësisë, mosreagimi i sistemit të drejtësisë në kuadër të problemeve dhe dilemave që dalin nga partnerët e ndryshëm. Mosfunksionimi i duhur tek operatorët e ndryshëm ekonomikë po shkakton pengesë, po ashtu edhe sistemi energjetik është pengesë. Ndoshta këto do të pakësohen me ndërtimin e termocentralit të ri. Prapë problemet qëndrojnë

tek pengesat që vijnë edhe nga segmentet e caktuara brenda partnerëve të Qeverisë, por edhe tek problemet nga segmentet e caktuara të cilat qëndrojnë në kuadër të interesave grupore dhe klanore që po shkaktojnë pengesë përpara. Ju e keni parë iniciativën e zëvendëskryeministrit Limaj për pezullimin e privatizimit të pronave. Pati reagime edhe nga partnerët e koalicionit. Disa janë të interesuar për t'i ndalur këto procese që hapin rrugë për zhvillim të vendit dhe për krijim e vendeve të punës.

**"Epoka e re":** Ministrat e Nismës Socialdemokrate po duket të jenë aktivë në detyrat e tyre. Sa po e kanë përkrahjen e partnerëve të koalicionit në vendimet që po marrin?

**Hoti:** Ministrat e Nismës Socialdemokrate po vazhdojnë ta jetësojnë programin e partisë, të cilën e kemi bërë të ditur edhe në fushatën elektorale. Në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, të Tregtisë

dhe Industrisë dhe atë të Arsimit, shihet se aktivitetet e tre ministrave janë në kuadër të programit që ka Nisma Socialdemokrate. Pengesat mund të vijnë nga aspekti administrativ, qoftë nga ato politike, sepse mund të shihet një garë që mund të reflektojë në rivalitet të partive politike. Nisma si subjekt politik, deputetët e saj dhe ministrat tanë e kanë mbështetjen e zëvendëskryeministrit Limaj që të bëjmë përpjekje maksimale për të krijuar mirëqenie më të mirë për qytetarët. Mendoj se pjesët e programit tonë kanë hyrë në binarë. Mbetet të shihet se sa do të realizohet programi ynë partiak, socialdemokrat. Kërkoj nga PDK-ja dhe kryeministri që programet që janë në interes të qytetarëve të vendit të mbështetën, pavarësisht se nga cila parti politike vijnë. Tani për tani mendoj se Qeveria Haradinaj e ka për obligim ta shtyjë përpara programin qeverisës.

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 18 MAJ - "Epoka e re": Z. Hoti, si vlerësoni ecjen e deritanishme të Qeverisë aktuale?

**Hoti:** Qeveria Haradinaj është e përcjell me një sërë aktivitete që po shihet se kanë ndikuar në

zhvillimin ekonomik, në mirëqenien sociale dhe në atë shëndetësore. Iniciativat tona janë që t'i shtyjme përpara obligimet që dalin në raport me detyrat që kemi para vetes sa i përket agjendës evropiane. Ne jemi duke punuar për zbatim të MSA-së. Gjithashtu, Bordi i Trepçës dhe disa borde janë funksional-

# të bëhet sa më shpejt



**"Epoka e re":** Debalanca tregtare që nga koha e pasluftës është një vazhdimësi e keqe, e cila vazhdon t'i kanoset Kosovës. Si mendoni të ndalet?

**Hoti:** Debalanca duhet të ndalet. Qeveria duhet të marrë masa dhe të paraqesë kushte dhe kriteret në sezona të caktuara. Pa dashur të shfaq si qëllim në vetvete kategorinë e prodhuesve dhe të përpunuesve vendorë, njerëzve punëtorë të vendit dhe kompanive tregtare, duke e mirëkuptuar jashtëzakonisht ekonominë e tregu të lirë, shteti duhet t'i mbështesë prodhuesit e vendit të cilët punojnë dhe ofrojnë prodhime vendore. Produktet tona kanë nevojë për përkrahje nga faza e prodhimit në shkallën e përpunimit. Kjo do të ishte fusha e cila do t'i rregullonte raportet mes eksportit dhe importit. Po ashtu, kjo do ta rriste nivelin e eksportit në vend. Po vërehet se ka një rezistencë nga ekonomia joformale, që prapë ndoshta grupet e caktuara të pushteteve dhe politikës qëndrojnë prapa këtyre tregtarëve. Shkallën e informalitetit që, fatkeqësisht, është rreth 30 për qind, e pranoi edhe Qeveria. Ky informalitet shihet në të gjithë hapësirën vendore dhe për këtë zhvillohet një konkurrencë jo e barabartë, me çmime joreale, që imponon çmim në treg dhe rrezikon edhe prodhuesin dhe përpunuesin vendor.

**"Epoka e re":** Sfidë në qeverisjen Haradinaj shihet edhe përformanca, apo pasqyrat financiare negative të ndërmarrjeve

shoqërore. Ç' duhet të bëhet që të ndalet kjo gjendje?

**Hoti:** Mendoj se tek ndërmarrjet shoqërore është një sëmundje apo ta quaj gangrenë e përhershme që nga paslufta e këndeje, e cila ka filluar të shndërrohet në një lloj kanceri për qeveritë në vazhdimësi. Kjo është shndërruar në një poligon për qeveritë dhe partitë politike sipas fuqisë së tyre. Pra, në një poligon për t'i kontrolluar dhe zhvatur të gjitha burimet publike, prandaj duhet të parandalohet.

**"Epoka e re":** Ju jeni ihtar i auditimit nga kompani audituese të jashtme. Pse?

**Hoti:** Po. Fillimisht duhet të bëhet një auditim i jashtëm i pavarur. Ky është propozimi im që e mbroj me fanatizëm, në mënyrë që të krijohet një mundësi e auditimit të pavarur të jashtëm dhe profesional për secilën ndërmarrje publike. Nga ky auditim të rezultojë një plan emergjent i Qeverisë Haradinaj për ndërhyrje, për faktin se Qeveria e Kosovës është aksionarja kryesore e ndërmarrjeve publike. Prandaj, nuk ka primat as bordi drejtues e as bordi ekzekutiv dhe as menaxhmenti i ndërmarrjeve, pasi ato borde janë ndërmarrje për vendin dhe Qeveria është aksionare kryesore. Kështu që, ne nuk duhet të merremi shumë me atë se çfarë thonë drejtuesit e bordeve apo të menaxhmenteve ekzekutive të këtyre ndërmarrjeve, por duhet të merremi më atë se ku duhet të shkojmë dhe sa janë shndërruar këto ndërmarrje në barrë për

qytetarët dhe Qeverinë e Kosovës. Është në interes jetik edhe për Qeverinë dhe për qytetarët që këto ndërmarrje ta ruajnë përmbajtjen e tyre, gjendjen ligjore dhe qëndrueshmërinë. Duhet ndërhyrje emergjente me një plan adekuat, profesional dhe të përgatitur mbi bazën e të gjeturave të auditimit. Kështu që, njerëzit që kanë bërë shkelje u hapet rruga e llogaridhënies. Ndërmarrjet publike në këtë gjendje nuk bën të shkojnë në procesin e privatizimit dhe as të kolapsit. Pra, po ritheksoj edhe një herë se segmente të caktuara kanë pasur qëllim që ndërmarrjet publike të vijnë në buzë të kolapsit, më pas t'i nënshtrohen privatizimit. Për shembull, nëse Posta ka mundur të privatizohet me 300 milionë euro, tani nuk është në rregull të privatizohet me një vlerë prej 30 milionë eurosh, kur dihet se para pesë vjetësh vetëm dividendin e ka pasur 15 milionë euro. Për gjendjen e sotme të Postës dikush duhet të japë llogari. Posta i ka mbi dy mijë punëtorë. Si mundet dikush ta marrë një pagë si drejtues i një dikasteri 4 000 euro deri në 5 000 euro kur kjo ndërmarrje është para kolapsit.

**"Epoka e re":** Qeverisja Haradinaj është kritikuar edhe për shpenzime enorme, edhe për numrin e madh të zëvendësministrave. A mendoni se kjo Qeveri do ta çojë mandatin deri në fund?

**Hoti:** Kuptohet se nuk na bënë nder një Qeveri me 70 zëvendësministra. Kjo çështje është trashëguar nga qeveritë e

mëparshme dhe ka vazhduar edhe kësaj radhe me numër të madh të zëvendësministrave. Derisa ka mungesë të Ligjit për Qeveri kjo gjendje do të përsëritet. Mendoj se në këtë drejtim ka kontribuar edhe partneriteti i shumë forcave politike në bashkëqeverisje dhe sigurisht se shpenzimet, siç thoni ju, janë enorme, janë të paarsyeshme dhe të padobishme. Këtë situatë mund ta zgjidhë vetëm Ligji për Qeverinë. Pra, sa më shpejt duhet të bëhet Ligji për Qeverinë pastaj, pavarësisht prej çfarëdo rezultati zgjedhor, atëherë duhet t'i përmbahemi këtij ligji. Forcat politike pastaj e dinë se kur të krijohen koalicionet duhet të krijohen brenda një kornizave ligjore.

**"Epoka e re":** Pos Ligjit për Qeverinë, mungon edhe Ligji për nivelim të pagave.

**Hoti:** Jemi të bindur se reforma në administratë është një prej reformave më të vështira dhe kërkon me të vërtetë një lidhshmëri të qëndrueshëm dhe të fortë. Pa një reformë administrative nuk mund të stabilizohet gjendja në vend. Sigurisht se nivelimi i pagave nuk është duke u konvnuar atyre që i kanë privilegjet e veta. Nuk ka gatishmëri dhe vullnet politik për t'i hyrë kësaj reforme. Mendoj se Qeveria aktuale duhet ta gjejë formën që, pavarësisht prej penalizimeve që mund t'i marrë në të ardhmen, kjo do të çonte në funksion të stabilizimit të vendit. Mendoj se edhe qytetarët do ta mirëkuptonin nëse do të kishte një reformë të drejtë dhe nivelim të pagave.

## PZAP-i: Nga 15 parti politike të gjobitura, dy nuk i kanë shlyer borxhet

PRISHTINË, 18 MAJ - Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) i ka bërë publike gjobat që u janë shqiptuar partive politike për shkak të shkeljeve të bëra gjatë organizimit dhe mbajtjes së zgjedhjeve lokale të 22 tetorit 2017 për raundin e parë dhe raundin e dytë. Gjatë këtij procesi zgjedhor PZAP-ja ka dënuar me gjoba gjithsej 15 (pesëmbëdhjetë) subjekte politike në vlerë prej 257 350 eurosh. Prej tyre, 13 subjekte politike i kanë paguar gjobat në total prej 239 700 eurosh, ndërsa 2 subjekte politike ende nuk i kanë paguar gjobat në shumën prej 17 650 eurosh. Subjektet politike, të cilat janë dënuar me gjoba dhe të cilat i

kanë paguar ato janë: Lidhja Demokratike e Kosovës është dënuar me 78 550 euro, Lista Serbe me 38 550 euro, Lëvizja Vetëvendosje me 39 400, pastaj Partia Demokratike e Kosovës me 34 950 euro, Aleanca Kosova e Re me 20 050, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 17 200 euro, NISMA me 6 950 euro, Partia Demokratike Turke e Kosovës me 2 450 euro, si dhe pesë parti të tjera me dënime nën 1 000 euro. Kurse subjektet politike të dënuara, por që nuk i kanë shlyer borxhet, janë Alternativa me 15 450 euro dhe KTAP-ja me 2 200 euro. Mjetet financiare të paguara nga subjektet politike janë transferuar në buxhetin e Republikës së Kosovës.



## Mbahet testi i arritshmërisë për klasat e nënta

27 mijë nxënës në të gjithë Kosovën i janë nënshtruar të premtën testit të arritshmërisë. Ky test përmban 100 pyetje nga lëndët gjuhë shqipe, matematikë, gjuhë angleze, kimi, fizikë, gjeografi, histori, informatikë dhe ka për qëllim orientimin e nxënësve për shkollimin e mëtejshëm.



EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 18 MAJ - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyri, me rastin e mbajtjes së testit të arritshmërisë, ka vizituar të premtën Shkollën Fillore "Elena Gjika" në Prishtinë. Testit të arritshmërisë i janë nënshtruar rreth 27 mijë nxënës në të gjithë Kosovën. Ministri Bytyri ka përgëzuar Divizionin për Vlerësim, Standarde dhe Monitorim dhe drejtoritë komunale të arsimit për përgatitjet e duhura që nxënësit t'i nënshtrohen testit të arritshmërisë, i cili ka për qëllim verifikimin e gjendjes në arsim. "Qëllimi i matjes së arritshmërisë nuk ka të bëjë vetëm me matjen e arritshmërisë, por edhe me verifikimin e gjendjes dhe marrjen e masave për ta ngritur cilësinë.

Përgatitjet kanë shkuar mirë. Jemi të interesuar që rezultatet të jenë reale. Të gjithë jemi të interesuar që në klasat tona mësimdhënësi ta shtojë përgjegjësinë sepse mësimdhënësi nuk është vetëm një i punësuar, por përtej kësaj", ka thënë ministri Bytyri. Ndërsa drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit në Prishtinë, Jonuz Salihaj, ka thënë se është shumë i rëndësishëm vlerësimi i jashtëm për nxënësit e klasave të nënta dhe se pret rezultate të mira në fund të këtij procesi. Testi i arritshmërisë është organizuar në 108 qendra testimi dhe ka për qëllim orientimin e nxënësve për shkollimin e mëtejshëm. Testi i arritshmërisë përmban 100 pyetje nga lëndët gjuhë shqipe, matematikë, gjuhë angleze, kimi, fizikë, gjeografi, histori, informatikë.

## Veseli premtion qasje më progresive për diasporën

PRISHTINË, 18 MAJ (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur të premtën përfaqësues të diasporës nga shumë vende të botës, të cilët me mbështetjen e kryeparlamentarit Veseli po qëndrojnë në Prishtinë. Takimi është organizuar nga Kuvendi i Kosovës në bashkëpunim me organizatën "Germin". Gjatë adresimit në seancë solemne para përfaqësuesve të diasporës, kryeparlamentari Veseli ka thënë se diaspora ka qenë gjithmonë shtyllë e rezistencës dhe lirisë së Kosovës. "Që nga Rilindja Kombëtare e deri në ditët e luftës për çlirimin e Kosovës, të gjitha projektet e mëdha të kombit tonë kanë filluar në mesin e diasporës sonë. Pa diasporën, Kosova sot nuk do të ishte këtu ku është. Sot ajo është shtyllë e ekonomisë dhe shtetit



të Kosovës, prandaj shteti i Kosovës ka obligime të mëdha ndaj bashkatdhetarëve tanë, kudo që ata jetojnë e punojnë nëpër botë", ka thënë Veseli. Ai ka shtuar se ka ardhur koha

që Kosova të lëvizë përtej të kuptuarit të diasporës. "Sot njerëzit tanë në diasporë janë të integruar në trendet më të avancuar të zhvillimit dhe të dijes. Ata janë investitorë dhe menaxherë

kompanish të mëdha. Janë drejtorë bankash e sipërmarrës të suksesshëm. Janë intelektualë, ekspertë e përfaqësues institucionesh shtetërore. Zëri i tyre dëgjohet gjithandej botës, e lista

e sukseseve të tyre është e gjatë. Kjo na bënë krenarë. Diaspora jonë përbën një potencial të madh, nga i cili mund dhe duhet të përfitojë Kosova. Kjo mund të arrihet duke ndërtuar komunikim praktik institucional me njerëzit tanë në diasporë, me idetë e tyre dhe me potencialin e tyre investiv", ka thënë Veseli. Kryeparlamentari Veseli ka thënë se Ministria e Diasporës është duke bërë një punë të mirë, por të pamjaftueshme. "Është urgjente që potenciali investiv i diasporës të vendoset si prioritet i lartë në strategjitë zhvillimore të Kosovës. Njëkohësisht, në secilin institucion të vendit duhet ta vendosim parimin e dyerve të hapura për projektet dhe idetë që vijnë nga njerëzit tanë në diasporë. Në radhë të parë, kjo nënkupton politikë zero ndaj barrierave burokratike për diasporën", është shprehur Veseli.

## Kosova, misione diplomatike në Katar, Poloni e Portugali

PRISHTINË, 18 MAJ (ER) - Presidenti Hashim Thaçi ka nënshkruar të premtën dekretet për themelimin e misioneve diplomatike të Kosovës në nivel të ambasada-

dave në shtetin e Katarit, në Republikën e Polonisë dhe në Republikën e Portugalisë. Presidenti i Kosovës dekretet për themelimin e këtyre tre

misioneve diplomatike i ka nënshkruar në mbështetje të neneve të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Themelimi i misioneve diplomatike të Kosovës në

shtetin e Katarit, Republikën e Polonisë dhe në Republikën e Portugalisë është në shërbim të forcimit të marrëdhënieve tona shtetërore dhe diplomatike.



# Njohësit e sigurisë: Ushtria të bëhet përmes ligjit

Njohësit e sigurisë, Ramadan Qehaja dhe Kadri Kastrati, kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se Kosova nuk duhet të vonohet në transformimin e FSK-së në ushtri. Sipas tyre, Kosova nuk mund të presë në pafundësi që Lista Serbe ta ndryshojë qëndrimin sa i përket formimit të ushtrisë. Qehaja dhe Kastrati kanë thënë se meqë Lista Serbe heziton t'i votojë ndryshimet kushtetuese, atëherë duhet të shkohet me planin 'B', që ushtria e Kosovës të formohet përmes ligjit, por duke ia shpjeguar arsyen për këtë iniciativë faktorit ndërkombëtar dhe miqve amerikanë

do t'i votojë ndryshimet kushtetuese. Prandaj, duhen ndërmarrë masat e tjera apo plani 'B' që të shkohet nëpërmjet Ligjit për FSK-në. Përmes ligjit emri i mbetet FSK-së, por do t'i ketë atributet dhe detyrat shtesë që kanë të bëjnë me çështjet ushtarake. Këtë duhet ta bëjmë patjetër", ka deklaruar Qehaja.

Ai ka thënë se iniciativa për formimin e ushtrisë përmes ligjit do të përcillet me presion por, sipas tij, Kosova duhet t'i rezistojë këtij presioni. "Presioni do të jetë shumë i madh, por në këtë situatë duhet ta gëlltitim presionin dhe të shpjegojmë në planin diplomatik se duhet patjetër ta formojmë Forcën e Armatosur të Kosovës. Pesë deri në shtatë vjet i duhen ushtrisë sonë të vogël që të konsolidohet, prandaj nuk mund të presim në pafundësi për të mos filluar ndërtimin e saj. Në gjendjen në të cilën jemi dhe kur i dimë pretendimet territoriale të Serbisë ndaj Kosovës, na duhet ta kemi forcën tonë mbrojtëse", është shprehur Qehaja.

Kurse sa i përket reagimit të ShBA-së, se ushtria e Kosovës duhet të formohet vetëm përmes

ndryshimeve kushtetuese, ai ka thënë se kjo është politikë amerikane afatgjatë për të mos "tronditur dhe hidhëruar" komunitetin serb. "Politika amerikane dëshiron mos të ketë 'tronditje' dhe që pala serbe mos të 'hidhërohet'. Kjo është politikë afatgjatë amerikane që mendon se kështu duhet të ndodhë. Por ne duhet t'u shpjegojmë miqve tanë amerikanë pse po shkojmë me planin 'B' meqë nuk mund të presim më", ka theksuar Qehaja. Edhe ish-komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Kadri Kastrati, ka thënë të premten për gazetën "Epoka e re" se Kosova është duke humbur kohë sa i përket formimit të ushtrisë. Ai ka kërkuar nga institucionet e vendit ta bindin faktorin ndërkombëtar se ushtria nuk mund të mbetet peng i Listës Serbe dhe Beogradit. Sipas Kastratit, nëse jo me ndryshime kushtetuese, ushtria duhet të bëhet përmes ligjit. "Në aspektin ligjor mund të bëhet. Kushtetuta kërkon të ndryshohet emri i Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura, kurse përmes ligjit nuk mund t'i ndryshohet emri FSK-së, por mund t'i jepet mandati ushtarak. Përmes

ndryshimit të ligjit mund t'i ndërrohet misioni FSK-së. Pastaj në bazë të misionit FSK-ja mund të pajiset me armatimin që është paraparë në bazë të projektit për Forca të Armatosura. Qeveria e Kosovës duhet ta ngarkojë ministrin e FSK-së, komandantin e FSK-së dhe gjeneralë të nivelit të lartë që të shkojnë në Bruksel për t'u sqaruar ambasadorëve të NATO-s se transformimi i FSK-së nuk e rrezikon askënd. Pra, formimi i ushtrisë së Kosovës do të jetë në dobi të rajonit", ka deklaruar Kastrati, duke shtuar se pas ndryshimit të misionit, FSK-së i hapet rruga për anëtarësim në NATO. "Pas anëtarësimit në NATO, FSK-ja mund të eksportojë siguri duke marrë pjesë në operacione të ndryshme jashtë vendit. Qeveria duhet të bëjë më shumë përpjekje për ta bindur faktorin ndërkombëtar që Kosova nuk mund të mbesë peng përgjithmonë i komunitetit serb i cili është i dirigjuar nga Beogradi dhe ata nuk duan që Kosova të ketë ushtri", ka theksuar Kastrati. Duke folur për reagimin e ShBA-së, se transformimi i FSK-së duhet të ndodhë vetëm përmes ndryshimeve kushtetuese, ai ka thënë se kurrë asnjë shtet nuk do të thotë bëni çfarë të doni dhe, sipas Kastratit, formimi i ushtrisë është e drejtë e shtetit të Kosovës. "Formimi i ushtrisë është e drejtë e jona. Duhet të këmbëngulim se jemi shtet i pavarur, sovran dhe kemi të drejtë ta formojmë ushtrinë. Nuk ka vend tjetër përveç Kosovës ku komuniteti serb gëzon më shumë të drejta dhe i cili nuk dëshiron që Kosova të ketë ushtri. Mënyra se si silltet komuniteti serb në Kosovë tregon se kurrë nuk do t'i votojë ndryshimet kushtetuese për formimin e ushtrisë. Prandaj, nuk mund të mbesim peng i komunitetit serb. Duhet t'i tregojmë faktorit ndërkombëtar se kemi pritur që dhjetë vjet, prej shpalljes së pavarësisë dhe Kosova nuk mund të pres më tepër. Është e qartë se ushtria e Kosovës nuk e rrezikon askënd, më së paku komunitetin serb dhe rajonin. Ushtria e Kosovës do të jetë në dobi të rajonit në të ardhmen", është shprehur Kastrati.

EPOKA  
ERE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 18 MAJ - Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka paralajmëruar se transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri do të ndodhë qoftë përmes ndryshimeve kushtetuese ose përmes ndryshimit të ligjit. Kjo deklaratë është mirëpritur të premten nga njohësit e çështjeve të sigurisë. Eksperti i çështjeve të sigurisë, Ramadan Qehaja, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se është koha e fundit për formimin e ushtrisë meqë Kosova nuk mund të presë deri në pafundësi komunitetin serb për ta

ndryshuar qëndrimin. "Që tre vjet jemi duke pritur dhe duke marrë opinione të ndryshme. Rolin më të madh për të mos formësuar Forcat e Armatosura e ka Serbia, e cila ka arritur që nëpërmjet diplomacisë dhe politikës të krijojë një opinion negativ tek disa shtete, sidomos tek ato që nuk e kanë njohur Kosovën, por edhe te disa shtete që e kanë njohur Kosovën që të deklarohen kundër formimit të Forcave të Armatosura. Është koha e fundit që të formohen Forcat e Armatosura, nëse jo përmes ndryshimeve kushtetuese, atëherë përmes ligjit. Lista Serbe është derivat i politikës së Beogradit dhe nuk



## Shpallen të pafajshëm Fuad Ramiqi dhe katër imamët e akuzuar

PRISHTINË, 18 MAJ - Gjykata Themelore e Prishtinës ka liruar Fuad Ramiqin dhe katër imamët Bedri Robaj, Idriz Bilibani, Enes Goga dhe Mazllam Mazllami, të cilët akuzoheshin për kryerjen e veprave penale thirrje për rezistencë dhe për veprën penale shtytje për kryerjen e veprave terroriste.

Sipas gjyqtarit Vesel Ismaili, gjykata nuk ka gjetur fakte ashtu siç ka pretenduar Prokuroria e Shtetit.

Në mungesë të provave, të gjithë të akuzuarit janë liruar nga aktakuza. Lideri i Lëvizjes "LISBA", Fuad Ramiqi, akuzohej për kryerjen e veprës penale thirrje për rezistencë, kurse imamët

Bedri Robaj dhe Idriz Billibani akuzoheshin se me veprimet e tyre kanë kryer veprën penale shtytje për kryerjen e veprave terroriste. Përderisa Enes Goga dhe Mazllam Mazllami akuzoheshin për kryerjen e veprës penale nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik.



## Hamza e informon ambasadorin Delawie me gjendjen financiare në Kosovë

PRISHTINË, 18 MAJ (ER) - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka takuar të premten ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Greg Delawie, të cilin e ka falënderuar për mbështetjen që Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës po e jep për zhvillimin e shtetit të Kosovës, duke përfshirë edhe shumë projekte në Ministri të Financave siç janë projektet e mbështetura nga USAID dhe Thesari Amerikan. Ministri Hamza e ka informuar ambasadorin Delawie për progresin që është duke u bërë në fushën e financave në vendin tonë. Po ashtu, ministri Hamza e ka informuar ambasadorin

amerikan Delawie edhe me përgatitjet që janë duke u bërë në fushën e politikave fiskale, që do të kenë shumë ndikim në zhvillimin e sektorit privat, si dhe për përgatitjet që janë duke u bërë për vizitën e Fondit Monetar Ndërkombëtar në Kosovë. Ambasadori Delawie ka vlerësuar punën e Ministrisë së Financave dhe u zotua se projektet e USAID-it dhe Thesarit do të vazhdojnë ta ndihmojnë zhvillimin e stafit në Ministri të Financave. Delawie ka thënë se është i lumtur që Ministria e Financave me agjencitë e veta po përfitojnë nga projektet e ofruara nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



## Një kompani italiane interesohet për ta shtrirë biznesin në Kosovë



PRISHTINË, 18 MAJ (ER) - Pas dy vizitave që ka pasur zëvendësministri i Tregtisë dhe Industrisë, Faton Thaçi, në Itali, për fushat e ekonomisë dhe të investimeve, ka filluar hapi i parë i konkretizimit të investimeve italiane në Kosovë. Thaçi të premten ka pritur në takim përfaqësuesin e kompanisë italiane "Prima Produzione Europe Di Alkekengi Physalis", Pierpaolo Cavaglieri, me të cilin ka biseduar për politikën fiskale dhe për sigurimin e investitorëve të huaj që shteti i Kosovës ofron. Zëvendësministri Thaçi e ka njoftuar biznesmenin italian se bujqësia është identifikuar si sektor strategjik për investimet e huaja që ndihmon në rritjen ekonomike dhe në gjenerimin e vendeve të punës. Ndërkaq Pierpaolo Cavaglieri ka

pohuar se është i kënaqur për zhvillimin e projekteve të reja në Kosovë. "Është një projekt i ri dhe i vetmi në Evropë që po përiqemi ta jetësojmë edhe në Kosovë. Ky projekt ka të bëjë me fushën e bujqësisë dhe sa i përket zhvillimit të agrokulturës, konkretisht frutit Alkekengi, ne jemi të parët në botë. Kultivimi i këtij produkti është shumë fitimprurës për fermerët e Kosovës dhe për këtë ne do të sjellim fabrikën nga Italia në Kosovë për përpunimin e këtij produkti, ku fermerët e kanë të siguruar tregun e shitjes", ka thënë biznesmeni italian. Gjatë këtij takimi Thaçi dhe Cavaglieri u pajtuan që ky bashkëpunim të vazhdojë me koordinimin e aktiviteteve konkrete deri në finalizimin e projektit.

## Rritet çmimi i derivateve edhe në Kosovë

PRISHTINË, 18 MAJ - Çmimi i derivateve ka shënuar rritje në të gjithë botën dhe kjo po vërehet edhe në Kosovë. Këtë e ka konfirmuar edhe kryetari i Shoqatës së Naftëtarëve të Kosovës, Fadil Berjani, i cili ka thënë se çmimi i naftës në Kosovë tashmë ka arritur në 1.10 euro.

Rritja e çmimit të naftës, që ka filluar gjashtë javë më parë, është më e madhja në katër vjetët e fundit. Të enjten çmimi për një barel ka arritur në 80 dollarë amerikanë. Ky çmim sipas ekspertëve është rritur si pasojë e problemeve mes ShBA-së dhe Iranit dhe krizës në Venezuelë. "Vitin e kaluar në të njëjtën kohë çmimi i naftës ka qenë 0.95 euro,

pasi ka qenë kuota ndërkombëtare e prodhimit e madhe, derisa tani prodhimi i derivateve ka rënie dhe në mënyrë automatike ka rritje të çmimit të derivateve në të gjithë botën, edhe në Kosovë. Por qytetarët e Kosovës janë duke u shërbyer me derivate me çmim më të lirë në rajon. Më lirë se në Shqipëri, Mal të Zi, Serbi dhe Maqedoni", ka thënë Berjani për "Radion Evropa e Lirë". Sipas tij, qytetarët e Kosovës dhe bizneset nuk kanë nevojë të krijojnë panik pasi, siç ka thënë Berjani, ata janë duke u shërbyer me çmime reale. Aktualisht çmimi i naftës në Kosovë është 1.10 euro, kurse i benzinës 1.11 euro.





# Haradinaj në Forumin Ekonomik të Vjenës: Kosova, e hapur për investime



Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë të premten para panelit të përbërë prej kryeministrave të vendeve të Ballkanit në Sofje të Bullgarisë, se Kosova është e hapur për investime të huaja të drejtpërdrejta. "Tani është koha të kemi investime të reja në shumë fusha, veçmas në miniera dhe telekom", është shprehur Haradinaj

huaja, tregtinë, digitalizimin dhe mobilitetin, që janë edhe temë e këtij forumi, duke shpalosur të arriturat e deritashme në fushën infrastrukturore dhe faktin se vendi në bashkëpunim me EBRD dhe EIB është duke planifikuar projekte të cilat e lidhin më shumë me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe me vendet evropiane. "Aktualisht Kosova ka përfunduar 65 për qind të rrugës që e lidhin Prishtinën me Shkupin, kemi nisur rrugën që lidhë Prishtinën me periferinë dhe që e njëjta do të vazhdojë edhe drejt kufirit me Mardare, me Shqipërinë është përfunduar tashmë, kurse deri në vitin 2022 të gjitha rrugët dytësore dhe regjionale në vend do të kenë qasje në autorrugët që lidhin Kosovën me Maqedoninë, Serbinë, Shqipërinë dhe Malin e Zi, derisa po punojmë për t'i nisur projektet hekurudhore që lidhin Kosovën me Serbinë", ka thënë Haradinaj.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se vendet e Ballkanit duhet më shumë të flasin me njëri-tjetrin sesa të flasin për njëri-tjetrin. "Në Samitin e Sofjes u përmend që procesi për njërin nga ne do të thotë proces për shumë prej nesh. Kosova është e hapur për investime të reja. Ne mirëpresim investime në telekom, në fushën e minierave dhe po presim nga ju të shprehni interesim. Një përshëndetje e veçantë për kryeministrin e Bullgarisë Boyko Borissov që ka kryesuar Presidencën e Evropës dhe që në këtë kohë, vendet e Ballkanit ishin më shumë të pranishme në agjendën evropiane. Në Kosovë kemi nevojë për të gjithë, kemi nevojë për njerëzit që marrin vendime dhe që ndikojnë në marrjen e këtyre vendimeve", ka thënë në fund të fjalës kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, në Forumin Ekonomik të Vjenës që po mbahet në Sofje të

Bullgarisë.

Gjatë këtij Samiti kryeministri Haradinaj ka thënë se Kosova me të gjitha kapacitetet mbështet vazhdimin e negociatave të Shqipërisë për anëtarësim në BE dhe se çdo pengesë në këtë drejtim është humbje edhe për regionin dhe për Evropën.

Pjesë e Forumit Ekonomik të Vjenës, përveç Kosovës, ishin Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia, kurse Forumi u mbajt nën kryesimin e kryeministrit të Bullgarisë, Boyko Borissov, vendi i të cilit kryeson me Presidencën Evropiane.

Kosova po përfaqësohet nga kryeministri Ramush Haradinaj, kurse pjesë e delegacionit janë edhe zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha dhe ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj.

EPOKA  
ERE

A. MAVRAJ

**SOFJE, 18 MAJ** - Në Forumin Ekonomik të Vjenës, i cili po mbahet në Sofje të Bullgarisë, kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se Kosova është e hapur për investime të huaja të drejtpërdrejta dhe se tregu është tejet i përshtatshëm për t'i prituri këto investime. "Kosova është një vend i vogël, me vetëm dy milionë banorë dhe ne jemi ndër vendet e rrala që kemi shpenzuar paratë nga buxheti ynë për të realizuar


projekte të mëdha infrastrukturore. Tani është koha të kemi investime të reja në shumë fusha, veçmas në miniera dhe telekom. Ne jemi të hapur për të gjithë investitorët dhe ky forum është mundësi e mirë për t'i ndarë këto mundësi", ka thënë kryeministri Haradinaj në fjalën e tij hyrëse para panelit të përbërë prej kryeministrave të vendeve të Ballkanit dhe Bullgarisë.

Haradinaj ka paraqitur interesimin e Kosovës për projekte nga fusha e Infrastrukturës, me theks të veçantë investimet e

## 'Policët e shtrirë' shtrihen në rrugën 'Vëllezërit Fazliu'

PRISHTINË, 18 MAJ (ER) - Njëpërmjet vendosjes së sinjalizimit horizontal dhe vertikal, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Prishtinës është duke u angazhuar për përmirësimin e kushteve në komunikacionin rrugor. Sipas Komunës së Prishtinës, veprime të tilla të kësaj drejtorie janë duke

ndikuar në rritjen e sigurisë dhe në uljen e numrit të aksidentëve. "Rrugës 'Vëllezërit Fazliu' në lagjen 'Kodra e Trimave', e cila i ka të rregulluar semaforët, ndriçimin publik dhe shenjat e komunikacionit, iu shtuan pengesat për makina - policët e shtrirë, të cilët ishin dëmtuar më parë", është thënë në njoftimin e Komunës së Prishtinës.



## Dëmtohen dy kisha ortodokse në Ferizaj

Ferizaj, 18 maj (ER) - Komuna e Ferizajt ka njoftuar se ka marrë informacion për thyerjen e xhamave në dy kisha ortodokse serbe që gjenden në territorin e kësaj komune, përkatësisht në Varosh dhe Talinoc të Muhaxherëve.

Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka dënuar këtë incident, të cilin e ka quajtur të shëmtuar. "Ky incident i thyerjes së xhamave të Kishës Ortodokse në Varosh dhe Talinoc të Muhaxherëve është një akt i shëmtuar i personave të pandërgjegjshëm për të cilët Policia e Kosovës dhe organet e drejtësisë kanë marrë veprimet e nevojshme. Ne

dënojmë këtë incident, duke e konsideruar një rast të izoluar dhe fare pa ndikim në klimën ndërfetare në komunën tonë. Veprimet e tilla janë kundër etikës religjioze të qytetarëve ferizajas, kur kemi parasysh faktin se komuna jonë është simbol i qytetit të tolerancës fetare", ka thënë Aliu.

## Më 21 maj dezinfektohen zonat endemike në Turjakë të Malishevës

Malishevë, 18 maj (ER) - Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Malishevës i ka informuar banorët e fshatit Turjakë se më 21 maj do të bëhet dezinfektimi selektiv i zonave endemike në këtë komunë. "Spërkatja e hapësirave publike do të bëhet duke filluar nga ora 8:00 deri në orën 12:00. Dezinfektimi do të bëhet më 21 maj në fshatin Turjakë. Të gjithë banorët e zonave ku do të bëhet dezinfektimi janë të obliguar t'i marrin masat e duhura preventive", është thënë në njoftimin e Komunës së Malishevës.



## PDK-ja merr katër drejtori në bashkëqeverisje me LDK-në në Pejë

përfaqësojnë këtë subjekt politik në koalicion me LDK-në.

Drejtorët e emëruar për drejtoritë përkatëse janë: 1. Xhevahir Çeku, drejtoreshë për Drejtorinë për Punë Komunale dhe Shërbime Publike; 2. Rajan Arapi, drejtor për Drejtorin e Urbanizmit; 3. Muhamet Mahmutaj, drejtor për Drejtorin Mbrojtje dhe Shpëtim/Emergjencë; dhe 4. Leotrim Murtezaj, drejtor për Inspeksion.

Marrëveshja për bashkëqeverisje në mes të PDK-së dhe LDK-së është arritur më 16 maj 2018, në bazë të secilës PDK-ja do t'i drejtojë katër drejtori.

Pejë, 18 maj (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Pejë, Xhavit Haliti, bazuar në statutin e partisë, ka emëruar katër drejtorët që do ta



## Në Drenas shënohet Dita Botërore e Hipertensionit

DRENAS, 18 MAJ - Me rastin e Ditës Botërore të Hipertensionit, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) "Dr. Hafir Shala" në Drenas ka organizuar aktivitetet parandaluese të kësaj sëmundjeje në Sheshin "Fehmi Lladrovci". Në aktivitetet që

janë mbajtur për parandalimin e sëmundjes së hipertensionit janë dhënë këshilla për mënyrën e drejtë të ushqyerit, të aktiviteteve fizike, është bërë matja e tensionit, matja e peshës trupore dhe matja e glikemisë së kalimtarëve të rastit.

## Kërkojnë trajtim të dinjitetshëm për kompensimin e tokave

GJILAN, 18 MAJ (ER) - Nën organizimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Komunës së Gjilanit është mbajtur të premtën një dëgjim publik me banorët e Malësisë së Zhegocit, ku është diskutuar në lidhje me procedurat për shpronësim të tokave në pjesën ku do të ndërtohet autostrada Gjilan - Prishtinë. Sami Ahmeti, i cili ka folur në



emër të kësaj pjese, ka kërkuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe institucionet e tjera të trajtohen me dinjitet sa i përket kompensimit të pronave. Ndërsa nënkryetari i Gjilanit, Arbër Ismajli, ka siguruar banorët e Malësisë së Zhegocit, se shpronësimi do të bëhet në formën që ata të jenë të kënaqur.

# Nafta vazhdon ta rrokullisë botën



**Shkruan: Agron HOTI**

Ditët e fundit kanë filluar të ngrehën çmimet e karburanteve në Kosovë, rajon dhe më gjerë, aspekt ky i padëshirueshëm për shfrytëzuesit e saj. Nga pamundësia për t'i përcjellë lëvizjet e çmimeve të naftës në bursa e tregje, qytetari i rëndomtë informatën e parë për rritje/ulje çmimi e merr rëndom në pikat e shitjes së karburanteve. Dhe në momentin kur qytetari përballet me rritje të çmimit, ngritja shkakton pakënaqësi ekonomike me pasojat sociale, sepse energjia, së bashku me ushqimin dhe ujën, janë tre faktorët më kryesorë për njerëzimin dhe kur këto tregje lëvizin ose debalancohen, atëherë është xhepi i qytetarëve ai që pëson ashtu sikundër pësojnë ekonomitë anekënd botës.

E pyetja që u intereson qytetarëve dhe afaristëve që shfrytëzojnë karburantet në baza ditore është se pse kanë filluar të rriten çmimet e karburanteve. Se çfarë është duke ndodhur me çmime të karburanteve në ShBA, Kanada, Rusi, Iran, Arabi Saudite, Irak, Azerbajxhan një qytetari të rëndomtë në Kosovë mund të mos i bëjë shumë përshtypje, kur e dimë se gjeografikisht jemi shumë larg këtyre zonave që vlijnë nga "ari i zi". Por realiteti është krejt ndryshe, janë pikërisht zhvillimet në politikën energjetike nëpër vendet prodhuese të naftës ato që ndezin dhe fikin motorët e zhvillimit global.

Shikuar në aspektin global, rritja e çmimeve të naftës është në favor të vendeve që zhvillimin e tyre ekonomik e kanë të bazuar në burime energjetike. Por kjo rritje

nuk duhet të shkojë pafund, sepse mund të bëhet e papërbalueshme. E ekonomitë naftë-prodhuese quhen konservative sepse zhvillimin ekonomik nuk e bazojnë në inovacion, por në resurse nëntokësore. Këto vende janë, ndër të tjera, Rusia, Arabia Saudite, Kuvajti, Iraku, Irani, Venezuela, Nigeria, Libia etj.

Ndërkohë që burime energjetike të theksuara kanë edhe Kanada e ShBA-ja, Norvegjia etj., por që ekonomitë e tyre nuk bazohen vetëm në burime energjetike. Sot për sot janë ekonomitë inovative ato që mbretërojnë globin. P.sh., vetëm Iphone, Samsung, Ali Baba, Google etj. sot për sot kanë qarkullim vjetor prej qindra miliardë dollarësh dhe nëse e masim qarkullimin me vlerë monetare, atëherë përfitimet e firmave të teknologjisë informative dhe rrjeteve sociale janë aq të larta sa që industria e naftës as që mund t'i arrijë ndonjëherë.

T'i kthehemi prapë naftës. Bota në dukje është paqësore në shumicën e pjesëve të saj, por lufta ekonomike për burime dhe tregje energjetike asnjëherë nuk është ndalur dhe as që do të ndalet ndonjëherë. Dhe duke jetuar nën këso konstelacione ndërkombëtare të paqëndrueshme, shtetet e vogla nuk mund të jenë immune ndaj lëvizjeve të çmimeve të derivateve ashtu siç nuk mund të jenë as shtetet e mëdha në raste të caktuara.

Nuk është aspak çudi që të bie një qeveri p.sh. në Ballkan apo në ndonjë pjesë të botës si rezultat i rritjes së çmimeve të naftës në glob. Kjo sepse rritja e çmimit të naftës mund të bëhet e papërbalueshme për qytetarët e vendit apo vendeve të prekura. Rritja e çmimeve të naftës ndikon edhe në rritjen e çmimeve të artikujve të konsumit, kjo automatikisht zvogëlon fuqinë blerëse të shtresave të varfra, rrit pakënaqësinë e popullsisë dhe kjo në të shumtën

e rasteve shkakton greva, protesta dhe rënie të qeverive. Dhe kur çmimet e derivateve bëhen të papërbalueshme, atëherë ekonomia paralizohet e kjo mund të rezultojë edhe me kolaps shteti.

Ose nuk është aspak çudi që një rritje e prodhimit të naftës nga të gjitha shtetet prodhuese të botës do të de-balanconte seriozisht tregjet globale dhe do të mund ta rrezonte p.sh. Qeverinë në Rusi, Arabi Saudite apo Iran, kjo sepse oferta do të rritej shumë në krahasim me kërkesën për naftë e si rezultat i saj këto vende do të duhej të zvogëlonin eksportin, e kur zvogëlohet eksporti bie prodhimi, kur bie prodhimi, bien të hyrat vjetore dhe me këtë fillojnë pakënaqësitë e përgjithshme qytetare përfshirë trazira të dhunshme që mund të paralizojnë shtetin apo shtetet e prekura.

Nuk është e rastësishme që Rusia dhe Arabia Saudite në bashkëpunim me aleatët e tyre të O P E C - u t (Organization of Petroleum-Exporting Countries) kanë filluar që të kufizojnë prodhimin e naftës që nga janari i viti 2017. Dhe qëllimi këtu nuk është për të rritur çmimet se sa për të zvogëluar sasitë e depozituara globale të naftës. Ndërkohë që prej 2014 deri në 2017 Rusia bashkë me Arabinë Saudite dhe vende tjera e

rritën prodhimin me qëllim të uljes së çmimit të naftës dhe për të ulur prodhimin e naftës nga SHBA-të dhe Kanada në mënyrë që të ulëshin fitimet për këto dy shtete.

Si Rusia ashtu edhe Arabia Saudite janë duke bërë përpjekje në të gjitha drejtimet përfshirë presionin diplomatik në OPEC për të vazhduar me zvogëlimin e prodhimit të naftës edhe gjatë vitit 2018. Ndërsa, OPEC pati vendosur që ky zvogëlim prodhimi të zgjaste jo më shumë se deri në mars 2018. E OPEC-u ka udhëzuar që të rriten çmimet e naftës duke ulur prodhimin nga 2.5 në 1.6 milion barela për ditë. Në tërë këtë 'katrahurë' prodhimi e çmimesh të naftës e luftë tregjesh anekënd globit secili megaprodhues është duke u munduar ta gjejë veten me qëllim të stabilizimit të çmimeve në tregje dhe stabilizimit të ekonomive të tyre. Arabia Saudite e Rusia janë duke shfrytëzuar rezervat shtetërore për të mbajtur GDP-në stabile si rezultat i rënies së eksporteve të naftës dhe çmimeve bashkë me to.

E pikërisht këto dy shtete janë të interesuara në ribalancimin e tregjeve të naftës për të siguruar stabilitetin e nevojshëm ekonomik edhe ashtu të luhatshëm. Kriza e tregjeve të naftës ka

zbehur dukshëm popullaritetin e Presidentit të sapozgjedhur rus, Vladimir Putin dhe një ribalancim i tregjeve të naftës do t'i ndihmonte atij ta mbante autoritetin e tij gjallë. Mbetet të shihet nëse kjo do të funksionojë pa elemente represive.

Se si do të lëvizin çmimet e naftës në të ardhmen është e vështirë të shihet me saktësi. Por, ajo çfarë shihet në horizont është fakti që vende si Kina, India, Brazili, Azia Juglindore, Pakistani, etj, do të shënojnë rritje të importeve të naftës si rezultat i rritjeve ekonomike gjithandej. Ndërsa, nevoja për naftë në përfundim do të jetë e njëtrajtshme me tendencë zvogëlimi importesh si rezultat i zëvendësimit të naftës me energji alternative dhe si rezultat i politikave inovative që do ta përshkujnë perëndimin e pasur gjithandej.

Një gjë është e sigurt, në qoftë se shtetet, ekonomitë e të cilave varen nga burimet energjetike si Rusia, Arabia Saudite, Venezuela, Irani, etj, nuk do të mund t'i arrijnë projeksionet e parapara nëpër buxhetet vjetore të tyre, atëherë për pasojë do të përballeshin me zvogëlim të të hyrave dhe rritjes së krizave qeveritare gjithandej.

Sipas një studimi të OPEC-it përqindja e burimeve energjetike në glob në vitin 2000 ndahej kështu: nafta 40.1 %, gaz 23.3 %, në vitin 2010 naftë 38.7 gaz 25.7 %, e në vitin 2025 nafta 36.9 % dhe gazi 29.9 %. Meqë jetojmë në kontinentin e Evropës, atëherë ne si qytetarë të Kosovës, shikuar zhvillimet dhe trendet përreth nuk pritret të përballemi me ndonjë rritje drastike të çmimeve të naftës. Por, sigurisht që lëvizjet e çmimeve të naftës në bursa dhe tregje nëpër botë nuk do të mund të kalojnë pa u ndjerë edhe te ne. E kjo dëshmon më së miri që nafta do të vazhdojë ta rrokullisë botën edhe në të ardhmen.



## Shpërndahen 202 pako ushqimore për familjet skamnore në Mitrovicë

MITROVICË, 18 MAJ (ER) - Organizata "Islamic Relief", e cila tradicionalisht ndihmon familjet që kanë fëmijë jetimë dhe familjet skamnore, edhe këtë vit, për ndër të muajt të Ramazanit, ka shpërndarë pako ushqimore për familjet skamnore të Mitrovicës. Kjo

shoqatë të premtën ua ka shpërndarë nga një pako me gjëra ushqimore 202 familjeve në Mitrovicë.

Mohamed Soliman, drejtor i kësaj organizate për Shqipëri dhe Kosovë, ka thënë se shpërndarja e këtyre pakove ushqimore në qytetin e Mitrovicës do të

ndihmojë që sadopak familjeve skamnore t'ua zvogëlojnë hallet e mëdha që kanë. Ndërsa drejtoresha për Integritet Evropian dhe Mirëqenie Sociale, Nazan Kërveshi, ka falënderuar drejtuesit e kësaj organizate për kujdesin ndaj familjeve skamnore të Mitrovicës.



## Emri i ri i Maqedonisë, i pranueshëm për Bullgarinë

SOFJE, 18 MAJ - Ministrja e Jashtme e Bullgarisë, Ekaterina Zaharieva, ka deklaruar se për Bullgarinë është i pranueshëm emri "Republika e Maqedonisë së Ilindenit", duke iu referuar emrit të ri që mund ta ketë Maqedonia, pas

kontestit të emrit që kjo e fundit ka me Greqinë. Sipas saj, ky emër tregon se shtetet kanë një të kaluar të përbashkët. "Republika e Maqedonisë së Ilindenit do të thotë për mua se ata pranojnë që ne kemi histori dhe të kaluar të përbashkët, sepse kjo është pjesë shumë e rëndësishme e historisë bullgare, është moment shumë i rëndësishëm edhe për ata", ka thënë ajo.

Kryeministri maqedonas Zoran Zaevi ka njoftuar se të premtën do të zhvillojnë një

takim me krerët e partive dhe presidentin për të diskutuar propozimin që mund të jetë i pranueshëm për Maqedoninë dhe Greqinë. Kryengritja e Ilindenit është zhvilluar në vitin 1903 kundër Perandorisë Otomane.



## Stoltenbergu: Aleanca po i përgjigjet agresivitetit të Ruisë

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha se Rusia është bërë më agresive, prandaj Aleanca po përgjigjet duke shtuar përforsimet, më të mëdhatë që nga Lufta e Ftohtë

UASHINGTON, 18 MAJ - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, i tha Zërit të Amerikës se Aleanca po i përgjigjet agresivitetit të Ruisë duke shtuar numrin e trupave në krahun e saj lindor dhe në vendet baltike. Stoltenbergu ishte në Uashington për t'u takuar me presidentin Donald Trump dhe zyrtarë të tjerë të lartë amerikanë, me të cilët diskutoi edhe rreth rritjes së shpenzimeve ushtarake të NATO-s.

Kreu i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha se Rusia është bërë më agresive prandaj Aleanca po përgjigjet duke shtuar përforsimet, më të mëdhatë që nga Lufta e Ftohtë. "Kjo po bëhet duke shtuar trupat në lindje të Aleancës dhe në vendet baltike, në Poloni, por edhe me gatishmëri më të lartë të forcave tona. Ne duhet të bëjmë më shumë në këtë aspekt dhe ta rrisim gatishmërinë e forcave

tona gjatë takimit të NATO-s në muajin korrik në Bruksel", tha Stoltenbergu.

Ai tha se Moska po investon më shumë në pajisje moderne ushtarake. Rusia, tha ai, po përdor forcën ushtarake kundër një fqinji, Ukrainës, duke aneksuar ilegalisht Krimenë si dhe duke përdorur atë që ai e quajti taktikë hibride, një kombinim i veprimeve ushtarake me ndërhyrjen në proceset zgjedhore dhe sulmet kibernetike.

E gjithë kjo, tha kreu i NATO-s, kërkon një përgjigje nga Aleanca dhe ajo po përgjigjet. Ai tha se ekziston nevoja kritike që forcat e NATO-s të jenë në gjendje të lëvizin në Atlantik dhe në të gjithë Evropën. "Ne jemi në procesin e krijimit të një komande të re të forcës së përbashkët që do të përqendrohet në Atlantik dhe Shtetet e Bashkuara kanë ofruar që ta vendosin komandën e kësaj



force të re në Norfolk të Virxhinias. Po krijojmë gjithashtu një komandë të re për lëvizshmërinë dhe përforsimin në të gjithë Evropën dhe gjermanët kanë ofruar që ajo ta ketë selinë në territorin e tyre", tha ai.

I pyetur nëse e shikon Turqinë

ende si një aleatë të NATO-s, Stoltenbergu tha: "Turqia është një aleatë dhe një aleatë e rëndësishme, aq më tepër për vendndodhjen e saj gjeografike në kufi me Irakun dhe Sirinë. Turqia ka qenë e rëndësishme në luftën kundër Daesh-it apo ISIS-it. Ajo

ka përdorur infrastrukturën dhe bazat ajrore për ta luftuar ISIS-in, i cili tani është në arrati". Stoltenbergu pranoi se Turqia ka disa mosmarrëveshje me aleatët e NATO-s dhe i bëri thirrje Ankarasë dhe aleatëve të ulen e t'i zgjidhin dallimet mes tyre.

## Putini: Do t'i vazhdojmë dërgesat e gazit nëpërmjet Ukrainës



MOSKË, 18 MAJ - Presidenti rus Vladimir Putin ka thënë se Rusia synon t'i vazhdojë dërgesat e gazit natyror nëpërmjet Ukrainës. "Ne do t'i vazhdojmë dërgesat e gazit natyror nëpërmjet Ukrainës për aq kohë sa ato justifikohen ekonomikisht", tha Putini në një konferencë shtypi me kancelaren gjermane Angela Merkel.

Ndërsa aMerkeli tha se "roli i Ukrainës si vend transit duhet të ruhet dhe Gjermania është e gatshme ta luajë rolin e saj". Gazprom i Ruisë planifikon të

ndërtojë një tubacion të dytë nën detin Baltik në Gjermani, i quajtur Nord Stream 2.

Ukraina deri tani ka refuzuar propozimet nga Gazprom. Rusia i ka mbyllur më parë furnizimet në Ukrainë në mosmarrëveshjet për çmimet, të cilat kanë ndërprerë furnizimet në Evropë.

Merkeli tha se Gjermania e shih projektin Nord Stream 2 si një projekt biznesi. "Ka elemente të tjera, kështu që ne duhet të mendojmë për garancitë për Ukrainën", deklaroi Merkeli.

## Të shtëna në një shkollë në Teksas, tetë të vdekur

TEKSAS, 18 MAJ - Të varë dhe të plagosur njoftohen nga një incident me armë zjarri në një shkollë të mesme në Teksas. Në fillim të ditës mësimore një person hyri me armë në shkollën e mesme Santa Fe, jo larg

Hjustonit dhe filloi të qëllonte. Policia thotë se e ka arrestuar personin dhe aktualisht situata është nën kontroll.

Burime mediatike amerikane japin shifra të ndryshme për viktimat. "Nju Jork Times"

njofton për tetë të varë, bazuar në njoftimet më të hershme të një zyrtari lokal. Ndërsa kanali CNN njofton për tetë të varë, si dhe një numër të plagosurish, mes tyre edhe një polic që shërbente si

personel sigurie në shkollë. Ky është incidenti i tretë me armë zjarri në mjediset shkollore, i regjistruar këtë muaj në ShBA si dhe incidenti i 22-të i kësaj natyre që nga fillimi i vitit.



Shqyrtime letrare

# POETIKA E KLITHMËS ATDHETARE


(Ismail Syla, "Atdheu im i ngrysur", poezi, "Buzuku", Prishtinë, 2017)

Behar GJOKA

Në përmbledhjen "Atdheu im i ngrysur", poeti Ismail Syla, rimerr dhe shtjellon gjerësisht temën e atdheut, duke shqiptuar ndjesitë më të holla autoriale, në disa ngjyra. Atdheu, një kryetemë e ligjërimit poetik, e shpaluar në dritëhijet e lidhjeve të forta, jetike dhe të pashmangshme, të unit poetik me vetë ekzistencën, shpalohet në tri pamje. Libri hapet me poezinë Qeni i lidhur në degë, e cila paralajmëron vokacionin mbi atdheun e nëpërkëmbur, ku vargjet përmblyllëse rrokin makthin: Dhe krejt në fund ma rrëzoi lirin / Dhe në degët e tij ai lidhi një qen / Që ende më turret, kërkon të më hajë... Marrëdhënia e lisit me qenin, zbulon tragjikën në fatin e njeriut, e qenies iliro-arbënorit. Ulja e siparit të këngës së pambarim, që ka në qendër atdheun, vjen në poezinë e fundit, që zbulohet në vargjet: Nga Porta Veriore e Atdheut tim u largua / E lehura onomatopeike "av, av" pa kthim / Atdheu im Aktual kujdes nga ham-hamet / Nga Vetëkafshimet tua - plagë pa shërim. Materia letrare organizohet në tre cikle kryesore poetike, ku madje ravijëzohet udha e bërë në historinë, afër dhe larg, si dhe me vështrim në ardhmëri. Substanca letrare e ciklit: "Atdheu i pabërë", ku përfshihen njëzet e tri poezi, shkon në zanafillën e mashtrimit të ekzistencës: Shpirti i kalorësit të fundit / në Betejën e Kosovës më 1389 / tjerr penj për qiellin e copëtuar, një klithmë që bredh nga shekulli në shekull, me mbajt peng fatin e Kosovës, që në histori ka qenë djep i shqiptarisë. Atdheu, në verbin poetik, nis te pragu, te vorri ku prehen rrënjët, por ndërkaq harku i dëshmisë, gjithnjë simbas botëpërceptimit të mishëruar në hapësirën e teksteve, është kudo. Më së pari, është në gjallimin e arbëresheve, që kanë të gdhendur epokën e kryetrimt, Gjergj Kastriot Skanderbegut, është në Dibër, Korçë, Sarandë, Shkodër e Drenicë, është ku i thonë bukës bukë. Materia poetike është një ikje në histori, ku gjen dhe sublimon sakrificat, përthekson rrezikun me shemb lirin, një topos identiteti, për të mbërritur në vargjet, që plasojnë gjithkohësinë: Në Atdheun tënd të pambrojtur / Kot i ik pusit, se të pret gjiri / Ik nga shiu dhe bjen në breshër / E prej tymit hyn drejt në prush / Mbetur jashtë hijes së gjilpërës / Me kokë në diell e gushë në fushë, (f. 25). Situata poetike, e përcjellur pa nëntekst që bart shestimin, se ende atd-

heu është i pabërë, mbi të gjitha ngase është i pambrojtur. Në këtë udhëtim imagjinar në fatin e përgjakur të atdheut, poeti ndalet në historinë e afërt: Vinin në jetë / Në mes të ditës / ...në orët e natës / Të qarën e tyre të parë në jetë / E shoqëronte një krisëmë e granatës. / E qara e foshnjës në zonat e luftës / Ardheje e jetës mes topit dhe pushkës, (f. 28). Kujtesa, një term i Kunderës, sugjeron për të mos harruar se e keqja përsëritet: Gjeografia jonë hyri në meny të fqinjëve / Si mish i ëmbël supe i shtrirë në tryeza / Copa Atdheu në thela të prera me thikë / Janina, Ohri, Plava, Gusia dhe Preveza. (f. 29), që japin fatalitetin e copëtimit të trojeve shqiptare.

Cikli i dytë i librit, "Atdheu i ngrysur", ku përfshihen tridhjetë e një poezi, që madje përbën bërthamën e frymimit poetik, merr në sy dhe pendë, të tanishmen me mungesat e theksuara. Qysh në poezinë e parë: Atdheu im, djerrinë e inatit / Tokë e mbjellë me paranojë / Marrëzi të lashta korr e shin / Aq sa s'mund t'i konsumojë, ku shenjohet tragjika e bartur. Pjesa e atdheut, që sapo ka dalë nga thundra serbe, përçon një situatë të beftë: Atdheu im, me 11 mijë kilometrat katrorë / Pse rri kaq ndruajtur e nuk i shpalos vlerat? / Me horizontet të ngushta dhe urretjtje paanë / Mos Zoti të krijojë në ditën kur bëri humnerat?, të cilat identifikojnë përmasat e Republikës së Kosovës. Për ta ardhur në dëshminë e dramës çame: Vetmia në trajtën e ishujve grekë / Dhembja? / Nuk mund të jetë tjetër / Pos e llojit të dhembjes çame (f. 42), duke u pohuar kështu si poet i etnosit. Depërtimi në të qenit të ngrysur të atdheut, në dukje dhe në thellësinë e vetë, kërkohet në rrënjët frazeologjike të shqipës, si në vargjet: Ëndërrimtarë të kthyer e xurxull të dehur / Shkuan me blelesh e u kthyen të qethur. Hulumtimi në shkaqet e vonesës, të ciat i sheh brenda qenies: Vlo e mos përvëlo / Kalle e mos e digj / Bluaj e mos gatuaj / Gatuaj e mos piq. / Lutu e mos beso / Lëviz e mos ec / Kjo botë u shthur / O prapësi o dreq..., endur si një kalambur fjalësh, që zbulon dhe shenjon dramën e kohës së pakujdesit. Situata ironike, e kundërvënies ndaj indiferencës, theksohet në vargjet: Atje shekulli mbushet kaq shpejt: / Bjerraditësit viti i bëhet bjerramot. Mendimi për atdheun e ngrysur, në asht e frymë, pëson një përmbysje në vargjet e poezisë Epi për atdheasit e mi të lumtur: Në tërë tërësinë e Atdheut të tërë / Shumë atdheas e po aq atdhease /



Jetojmë të lumtur si në një hotel / Ngritur mbi ferr me pamje parajse. Mjeshtërisht tërheq vëmendjen në vargjet e poezisë Epi për kohën kur nuk ke me se të mburresh: E shkuara, sado e lavdishme që të jetë / Ngjan me ata filmat pa zë dhe pa ngjyrë. / Në kohën kur nuk ke me se të mburresh / Dhe Dielli që lind, perëndon në mynxyrë.

Cikli i tretë, "Për ty atdhe", që përmban njëzet e nëntë poezi, sendërton pamjen e atdheut: Në një zgurë lisi mund të strehohet bisha / Dhe ikanaku kërkon dy tjegulla mbi kokë / Nuk më ka pëlqyer kurrë shprehja strehë / Po shtëpi, me njerëz, e me rrënjë në tokë. Prania e një situatë të beftë poetike, shqiptohet në vargjet: Mund të suvatosh mure e mure pa fund / Dhe në heshtje të thurësh me mijëra fjalë / Me një pikë gjaku për Atdheun derdhur / Miliona pika djerse nuk bëhen barabar (f. 82). Në përvjetorin e kryetrimt, shkruan: 1. Dimri dhe vdekja, 17 janar 1468 Thellë tokës së Arbrit u hap varr i madh Vdiq / Gjergji i Kastriotëve - Skënderbeu / Bjeshka ra në fushë dhe fusha ra në det / Mug me re lotësh qiellit sipër rri Atdheu. Dashuria siprane për atdheun e lirë, lidhet me fatin personal: Nëpër Kashtën e Kumtrit erdhi liria (Motiv nga Burgu i Qarkut i Mitrovicës, 1982-1984) Në kthinat e Burgut me formën rrethore / Me Tokën silleshim përreth boshtit të saj / Ditët e netët bëheshin javë, e javët muaj / Duke kërkuar ëndrën në qiellin e pa skaj. Për të ardhur te figura e Ali Pashë Tepelenës, Vademekum për Ali Pashë TepelenënKoka: në kryeqytet, larg te Stambolli / Trupi: në Janinë, në varr - varg balade / Shpirti: dyqind vjet në adresë të saktë: / Te "Çajllid Haroldi" dhe te këngët labe. Poetika e atdheut, në hapësirën e përmbledhjes së mbarme të autorit, vjen e shpaluar në tri pamje, ku hetohet

fati i qenies, gdhendur në fytyrën e atdheut, që sendërtojnë klithmën se atdheu është vatra e qenies.

## Poezia popullore si paratekst

Sendërgjimi i ligjërimit poetik, krahas lidhjes tipologjike të hapur me poezinë gojore, si vargëzim dhe strofë, si frymë dhe ngjyresë, si figurim dhe shprehësi, vihet re se në këtë përmbledhje, shpërfaqet tipi i shkrimit të poezisë, së poetikave të bashkëshkrira, që kërkon qasje dhe interpretim. Është fjala për tipin e poezive, të ndërhuara me dy pjesë, ku pjesa e parë i përkon poezisë gojore, madje ashtu siç vjen në mbamendjen e nguros, dhe pjesa e dytë, ku shpaloset ligjëratat poetike e autorit. Kjo rrethanë e përveçme, një bashkëlidhje e poetikës orale me sendërtimin e poezisë personale, sjellë në fokus një tipologji të bashkëshkrimit poetik, ku poezia popullore, pra kujtesa shpirtërore e dikurshme, e ka bjerrë situimin paratekstual, e tanimë vjen si parafjalë e tekstit personal. Tipi i poezive të ndërthurjes së dy tipeve të ligjërimit poetik, gojor dhe autorial, në hapësirën ligjërimore të shkrirjes organike të tyre, është një dukuri më e përhapur në ciklin e parë të përmbledhjes së fundit të poetit, ndonëse feskset edhe në poezi të tjera. Pranëvënja e këtyllë, e gërshetimit me bashkëshkrimin e poezisë, është një dukuri tipike në ciklin e parë poetik. Për të kuptuar tiparin e shkrimit poetik të bashkëlidhur, po sjellim në vëmendje një nga tekstet poetike. Kështu në poezinë Nata e parë e robërisë në Atdheun e zhbërë që përbëhet nga dy pjesë:

A - Vargje të huamarra në poezinë gojore, kur shprehet: Shkumba e kuajve / Dheun e zbardhëlloj / Gjaku i bujarëve / Zu të rrjedh' si përrua / Dhe llëret' e zonjave / Si shandanë mbetën udhëve. 1 "Duall e bukura në derë", popullore arbëreshe, të cilat të shpien në mugullimat e kohës së qenies arbënore.

B - Vargje të autorit, kur shkruhet: Kur ranë ushtarët radhë me radhë e një nga një / Stemat, flamujt dhe gjithë këshqjellat e Arbërisë / Llërat e bardha të zonjave, të prera nga shpata / Si kandila ndriçonin në natën e parë të robërisë. (f. 10), që duket si një vijim i logjikës ligjërimore të poezisë gojore. Po kaq, si një materie organike, ngjet simbioza e faktologjisë poetike, ku gojorja dhe autorialja, janë në marrëdhënie të ndërsjella, ku prekim mesazhin e bartur në dy gjendje, që janë dy pika ujë të vatrës burimore të shqipës.

## Klasiciteti modern i frymës

Bërthama poetike e librit, e shtirë edhe në përmbledhjet e tjera me poezi, përçon edhe një "rreng" të formësimit të ligjëratës poetike, që formëson tipin e një poezi klasike, ndonëse të derdhur me frymë moderne. Kur them "rreng" është fjala për një dëshmi poetike, që të vë në mendime në mënyrën se si thuhet. Nëse teoria letrare, pohon se epi në vargje ka "vdekur" ose që e vijon jetën e vet, tashmë në roman, zhanrin e prozës së gjatë, një zhanër në proces të hapur, që vijon të përsoset. Në poezinë e autorit, por edhe në këtë përmbledhje, madje në titull ndeshet termi Epi, që do të kërkonte hulumtim, për të hyrë në kodet estetike, të bartjes në poetikën e librit dhe të shkrimit poetik të autorit. Ndërkohë që epi nuk lëvrohet më, prania e termit, madje në titull, në poezi të shkurtra, nga njëra anë është riformulim i ligjërimit të poezisë, si ndjesi ku lirizmi udhëton bashkërisht me epizmin, e secilës kohë. Në këtë praktikë, të ligjërimit të përveçëm poetik, të rimarrjes së epit, më tepër si frymë, kemi të faktuar dëshminë e poetit, si akt rrëfimi, i vetë kohës që po jetohet. Prania e termit, e sidomos përsëritja kaq e shpeshtë në ligjërimit poetik, me shumë gjasë është edhe një situim i gjetur i parodizimit të zhanrit, madje të përmbysjes së plotë të tij, ndërkohë që në ligjërimit letrar ka humbur terren. Poeti, edhe pse në kohërat moderne, kridhet në nënvetëdije, ku gëlojnë dija dhe marrëzia. Për të prekur këtë tipar po sjellim të plotë vargjet e poezisë Epi për dashurinë e përjetshme ndaj Atdheut, ku edhe njëherë tjetër, riktalizohet ndjesia e atdheut, teksta shprehet: Atdheu duhet dashur dhe kur të dhembin kockat / Më thotë motra ime Nixhare që nga faqja e tretë / E librit "Rasim Kiçina - Pamje Lirie", prej nga ajo / Shqipërinë dhe Kosovën vazhdon t'i dojë përjetë. Situimi poetik, duke shënuar Ep-in, në këtë përmbledhje, përsëritet në trembëdhjetë herë, në titullin e poezive, pa hyrë në situatat e pranisë së termit dhe frymës së ep-it, në hapësirat e poezive të librit. Fakti që stilema poetike, vendoset në titull, është një sugjerim që poezia sado personale, nuk e humbet adresën e frymës së kohës, e po kaq poeti, vijon të mbetet kronikani i secilës epokë, duke nënvizuar kështu shenjtërimin e vlerave shpirtërore të poezisë, e veçmas të poezisë për atdheun, vatrën parake të secilit poet, të secilës kohë dhe hapësirë.

# E VËRTETA QË PROTESTON NËPËR QIELL



DIJE DEMIRI-FRANGU

Njëmendësia ballkanike dhe transformimet etnopsikologjike, nën trysinë e ideve të reja demokratike, dalin të jenë intencë e temës së kësaj novele. Roli i individit në shoqëri, ndikimi i tij në ndërtimin e një bote pa urrejtje dhe pa luftë, jepet përmes diskutimit realist të trajtimit të masakrës së Dubravës gjatë periudhës së luftës të vitit 1999.

*Kujtimet në shishe* është prodhimi i parë letrar i autorit Mimir Ferko -alias Musli Berisha. Kjo novelë vlen të interpretohet pos si një shkrim fikcional, edhe si një dëshmi e kohës si dhe për idenë humane që përcjellë, për një pajtim ndëretnik të vështirë dhe shumë paragjykes. Duke qenë se novela del në formën biografike, narratori është personazhi kryesor dhe misioni i tillë, pavarësisht se mund të paragjykohej, del i sinkertë dhe bindës.

Nëse e kujtojmë C. Bernard, novela *Kujtimet në shishe* është një rikrijim i një të shkuare, në këtë rast jo shumë të largët (lufta e vitit 1999). Ky rikrijim i një lufte të pabarabartë, bëhet estetik në funksion të krijimit të ndijimeve shumë unike dhe jo të rëndomta, as për historitë e popujve të tjerë. Maji i vitit 1999, lufta Kosovë - Serbi, burgu i Dubravës dhe skenari serb për ta maskuar burgun si një kazermë ushtarake, në mënyrë që ta mashtronte NATO-n, dhe që NATO-ja të bombardojë mbi të, është imanenca e idesë së autorit, që niset për ta bërë të njohur këtë ndodhi tragjike. Kjo ide fashiste e pushtetit serb shkon e zgjerohet përmes narracionit që degëzohet në formën e një retrospektive e cila shfaqet si perspektivë rrëfimore, në formën e kujtimeve, të shkruara nga një viktimë e kësaj masakre, Shpend M. Kujtimet nxjerrin motivin e brendshëm të shkrimit të kësaj proze, e që del të jetë ndjenja morale-obliguese, për ta shënuar formën më gjenocidale të luftës së fundit. Autori i shpreh kujtimet lexuesit, përmes një të huaje, pasardhëse e drejtpërdrejtë e armikut, por e transformuar në një qytetare botërore, që nuk ka ndjenja shoviniste-nacionaliste, që nuk e njeh Kosovën si djep të Serbisë dhe as që e pranon dog-

mën se shqiptarët janë popull i egër e vrasës. Lexuesit, ia lexon këto kujtime pikërisht kjo, vajza beogradase e shek XXI, Ana (përfaqësuese e shoqatës Rinia për Serbinë e Re).

Ana, bijë e një ish-polici në Kosovë, të cilin ajo pret ta hasë në çdo faqe të kujtimeve të Shpendit, që i lexon në një hotel të Prishtinës. Insistimi i babait të saj, që kjo të mos vijë në konferencën që mbahej në Kosovë, atje ku ajo mund të vritej e të kidnapohej, e që më së miri është të mos fliste serbisht por anglisht, jep elemente të një etnopsikologjie tradicionale serbe, që në një masë është një njëmendësi ballkanike. Kjo novelë, e cila merr përsipër përshkrimin emotiv - në formën e kujtimeve të personazhit kryesor Shpend B, të masakrës dhe plojes serbe në Dubravë, del si shpalim i një loje të rrezikshme politike të palës serbe dhe të një lufte e urrejtjeje patologjike ndaj një populli duarthatë. Pala e pafajshme shqiptare në këtë burg nuk manifeston ndonjë krenari kombëtare, sepse ata aty nuk kanë luftë, aty bëhet masakër dhe njerëzit janë viktima, jo heronj. Kjo lojë del si një dështim politik, moral e human i palës serbe, gjë që vajzës së re serbe i prek ndërgjegjen dhe ajo nis e insiston në botimin e këtyre kujtimeve, duke u shkruar shumë shtëpive botuese. Krejt kjo bëhet për ta nxitur kujtesën, jo atë kombëtare sa atë humane, sepse kjo katrohurë e lexuar për lexuesin nga një personazhi serb-gazetare që është në një konferencë të OJQ-ve në Prishtinë, dëgjon rrëfimin dhe kërkesën e një viktime që të dënohet ky sulm. Ana beogradase bëhet kurioze dhe brenda natës i lexon kujtimet që paraprakisht ia kërkon me delikatesë Shpendit. Krejt leximi është impuls i kureshtjes së saj se mos babanë do ta hasë si aktor të masakrës. Brenda këtij makthi ajo i kalon ditët në Kosovë, që gjithsesi i duket e bukur. Autori, duke dashur t'i rrënojë paragjykimet e njëmendësisë së të kaluarës e mentalitetin fashist, Anën beogradase e takon me vajzën e Shpendit, tek e cila ajo nuk heton asnjë fije hakmarrjeje dhe nacionalizmi, gjatë komunikimit që e bëjnë në gjuhën angleze.

Romani gjatë gjithë kohës ruan diskursin e tij realist, i ikën retorikës emotive, pavarësisht prej përshkrimit të hollësishëm të plojes së Dubravës dhe përmes perceptimit kritik të Anës beogradase, krijon një besueshmëri për shpresën në vetëdijen humaniste dhe shfaq një trajtim relaksues të raporteve ndërnacionale, me idenë e rehabilitimit të tyre,

mision të cilin, si duket, ia lë gjenratës së re. Diogjeza, në këtë rast historia e '99-s, është nisma e së formën e imitimit të atij realiteti, pos si një përjetim autokton. Teksti këtu si një rrëfim autentik, është vetë intenca e narratives - të njihet pala serbe, shkaktarja e këtij gjenocidi me një prodhim makabër të sajën. Kështu raporti mes rrëfimit dhe kohës së ngjarjes del të jetë brenda konceptit modern të historisë - toka u takon atyre që e punojnë dhe e popullojnë, thotë protagonistja serbe, e cila del të jetë një zë tjetër i narrativit.

Ndarja e famshme autor - personazh - rrëfimtari, në këtë novelë sinkronizohet poetikisht e, para së gjithash, ata edhe si zëra rrëfimi i bashkon ideja e lirisë së individit, derisa kujtimet dalin si një peritekst, sepse janë ndarje në roman apo edhe integrim, që shpjegojnë deri edhe motivimin. Por, autori nuk abuzon me lirinë e trillimit, nuk ka hiperbolizime, zmadhime emocionale. Ai mbetet një rrëfues racional, shpeshherë edhe duke e dëmtuar fiksinin. Vetëdija e Anës del si vetëdije kritike dhe demokratike, pse jo edhe idealiste, sepse teknika poetike e receptimit kritik vendos frymën bashkëkohore për rikrijimin e çasteve të së kaluarës. Kujtimet kanë formën e kronikës. Afria kohore mes ndodhësë dhe rrëfimit të autorit në këtë roman nuk e dëmtton diskursin afirmativ të raporteve ndërnacionale. Edhe pse janë gjallë përjetuesit e këtij akti makabër, autori nuk ka hezitime në rrëfimin e tij ndaj ligjërimit del bindës dhe fryma e romanit është në harmoni me atë të personazheve, nuk ka heroizëm, ka përpjekje, kritikë pa dizajnime në emër të estetizmit. Edhe dashuria e Anes me Igorin fiton një racionalitet në këto çaste të njohjes me tragjedinë e Dubravës. Këtu, pos kohës e hapësirës që janë fakte dhe per-


sonazhit shumë periferik në vepër - Milosheviqit, i cili del edhe identifikues i së keqes dhe si element retrospektiv i grupeve shoqërore të mbetura nga koha komuniste, që njihen si organizata të veteranëve dhe bartëse të njëmendësisë ballkanike njëkohësisht, nxitëse të vazhdueshme të nacionalizmit dhe joshjes kah luftërat e reja, kujtimet janë ato që bartin parimin e gjasës, parimin manzonian që arsyetojnë nevojën antropologjike të autorit për një krahasim kohësh. Këto kohë i ndajnë vetëm dy decaie, por që kjo distancë kohe mund të mundësojë një pajtim. Ky dallim që bën autori mes këtyre kohëve të afërta krijon distancën që i mundëson elementin historik kësaj novele, sepse tani narracioni na ofron nivele të tjera sociale - shumë diferenciale, sepse edhe vetë kalimi i situatave shoqërore e mundëson qasjen ndaj dy kohëve. Koha e kaluar, fundi i komunizmit dhe koha e luftës, janë mjete përmes të cilave autori vendos historicitetin dhe ndërton diskursin narrativ, i dominuar nga realizmi për ta ndërtuar kualitetin mes temës dhe rrëfimit. Nuk kemi në roman ndjenja të forta, situatat jepen pa u subjektivizuar. Në aspektin shoqëror mund të veçojmë dy zëra, zëri i së kaluarës komuniste (Sloba, babai i Anës, veteranët beogradas) dhe zërat e aktualitetit, të demokracisë, siç janë Ana, Shpendi me gocën e tij e që përfaqësojnë në roman shtresën e vetëdijshme të shoqërisë.

Rrëfimtari, duke mos qenë vetëm një përfolës i ngjarjes, por shpesh edhe një analizues gjakftohtë dhe reflektues, arrin ta krijojë pikën e përbashkët për Shpendin e Anën e që është liria e popujve. Novelës i shton vlerën tema aksiomatike, në të cilën inkorporohen elemente politike - ekstraletare, që e shtyjnë rrëfimin shpesh në zgrip të publicistikës apo edhe detajet

triviale-bisedat e familjes serbe në Beograd apo edhe paragjykimet e ndryshme rreth etnive në këto hapësira, të diskutuara edhe në përditshmëri. Romani sjell pasojat psikologjike, vdekja e babit të Anës, shkak i presionit psikik të bashkëluftëtarëve të tij, e kujtesës asociative në raport me kohën aktuale. Pas ikjes në Beograd, jeta mendore e babait të Anës ishte e rëndë. Ai pëson sulm nga presioni i shokëve të tij nacionalistë, derisa e bija bën jetë intelektualeje, që mbron botën njerëzore përmes qëndrimit të saj kritik, pavarësisht prej pasojave. Ideja e saj dhe kërkesa që ua bënë shtëpive botuese në Beograd për botimin e këtyre kujtimeve, gati ia marrin kokën. Asaj i inskenohet një aksident automobilistik udhëve të Beogradit.

Domosdo koha e luftës është prosode i novelës, por aktualiteti nxjerr perspektivën e pajtimit brenda diskutimit të së vërtetës, që shtrihet si temë. Përdorimi i të dhënave të njohura për masakrën e Dubravës, natyrisht se një gjuhë më emotive, sado që rrëfimtari është një njeri i pjekur politikisht, por që zëri i vetëdijes qytetare nuk e lë as të fle, ndaj ky nis shkrimin e kujtimeve e të përjetimeve të këtij tmerri. Kështu, fakti dhe kujtimi i tij, ndërtojnë arkitekturën e rrëfimit të një tragjedie të kurdisur.

Autori është një narrator pa përcaktim ideologjik. Neutraliteti i tij e shton forcën e sugjestionit duke nxjerr në pah autoritetin e autorit. Titulli simbolik, *Kujtimet në shishe*, nxjerr intencën e autorit - kujtimet do të jetojnë dhe do të përhapen, qoftë edhe si disqe që brenda shishes, do të fluturojnë qiellit të Beogradit, derisa shtëpitë botuese beogradase refuzojnë botimin e tyre. Është një e vërtetë që, qoftë edhe përmes fluturimit në qiell, do të bëhet publike. Kjo na e kujton atë thënien popullore, se e vërteta del edhe nga kallami.



## Dasma Mbretërore, përgatitjet e fundit në Britani



**D**asma mbretërore britanike në mes të princit Harry dhe të fejuarës së tij, aktores amerikane Meghan Markle, është në përgatitjet e saj të minutës së fundit. E cilësuar si dasma që do të ndiqet nga një audiencë botërore rekord prej dy miliardë shikuesish

në Evropë, Amerikë, Afrikë e pjesë të tjera të botës, kjo dasmë do të ketë edhe mbulim mediatik shumë të madh. Dasma mbretërore, e cila do të zhvillohet sot (e shtunë) në qytetën mbretërore Windsor, në veri të Londrës, po u nënshtrohet kontrolleve mjaft të rrepta të sigurisë.

## Zbulohet shkaku i ndarjes së John Cen`'s dhe Nikki Bellës



**J**ohn Cena po përpiqet shumë për të fituar përsëri Nikki Bellan, por ajo nuk është gati për t'u rikthyer, raporton "TMZ". Pak ditë më parë ylli i mundjes ka pohuar se dëshiron të martohet dhe të ketë fëmijë me Nikkin. Për këtë çështje ka folur vet Nikki. "Unë besoj 100 për

qind se ai dëshiron të ketë fëmijë. Kjo më bën të kthehem pas dhe të hidhem në krahët e tij", ka thënë Nikki. Konflikti mbi fëmijët ka shkakuar çorientim të saj në lidhje me marrëdhënien e tyre. Ajo ka thënë se është lënduar shumë nga ky konflikt.




## Cristiano Ronaldo 'harron' Ligën e Kampionëve

**F**inalja e madhe e Ligës së Kampionëve është vetëm nëntë ditë larg. Cristiano Ronaldo ka gjetur kohë të pushojë me të dashurën Georgina Rodriguez. Revista "Diez Minutos" ka publikuar disa fotografi të çiftit


të famshëm duke kaluar momente romantike në një plazh në Ibiza. Cristiano dhe Georgina kanë marrë me vete vetëm Cristiano Ronaldo Junior, kurse fëmijët e tjerë më të vegjël i kanë lënë në shtëpi.

## Selena Gomezi dhe Justin Therouxi, "më shumë se vetëm miq"



**S**elena Gomezi dhe Justin Therouxi u kanë dhënë fund lidhjeve me partnerët e tyre. Këngëtarja u nda nga Justin Bieber, ndërsa Theroux nga aktorja e famshme Jennifer Aniston. Dhe tani 25-vjeçarja dhe aktori janë

'më shumë se vetëm miq'. Thuhet se Selena dhe 46-vjeçari janë njohur me njëri-tjetrin para shumë vjetësh përmes menaxherit të tyre, por kanë rënë tërësisht në dashuri me njëri-tjetrin.

<b>Autor:</b> <b>BENI</b>	PORT DETAR	HUMORISTJA JONË SHASIVARI	VËNIET E DATAVE	INTENSITETI, RENI	ARIANIT (perkdh.)	KAL SHALE	"ÇEÇENIA"	SHTET (fr.)	KËNGËTARI NJOHUR JOHN	PEZMETIMET E VESHËVE	NXITËS I NDONJË VEPRIMTARIE (sh.shq.)	↓	KËMISHË PREJ PËLHURË TË HOLLË	↓	SHTET NË AZI ..... LINDOR PJESË E TRUPIT	NJË (ang.org.)	ELEMENT KIMIK (Nt)	
KËNGËTARJA NË FOTO 1											NISHESTE							
TË QESHURAT TALLËSE											MJETI QË SHËRBEN PËR TË DREJTUAR VETURËN MELBURNI							
LEGJENDAT						KËNGËTARJA JONË MUSTAFA	AUTORET E FILMAVE TË VIZATUAR EMNAKJA E EMRIT ISIR											
MODERATORI YNË KRASTA				KLUB FUTBOLLI GREK	RYSHFETET OBJEKTI I BISEDËS						AKTORJA AMERIKANE .... FLYN BOYLE					OHAJO MONZA		
PËSHPËRIS FJALË MAGJIKE								NEONI ZË I LARTË E I HOLLË BURRI			LUMË NË AUSTRI (shq.) UNITED STATES AMERICA				SHKRONJA FQINJE			
<b>EPOKA ERE</b>	JONIDA MALIQI	MURG I VETËMUAR ERMELINDA MEKSI							QYTEZË SHQIPTARE NË MAL TË ZI (pashq.) TOKIO									
STREHIMORET PËR FEMIJË JETIMË										SAN ANTONIO PAMELA ANDERSON								
MIMOZA MUSTAFA			ISHULL NË SHQIPËRI						PËRFUNDIM NË SHAH RESHAT ARBANA									
<b>2</b> 					AUSTRIA		SAHATI QYTET NË IRAK (shq.)				ZANORJA E PESTË MASHKULLI I ARUSHËS							
	<b>EPOKA ERE</b>				DIREK I ÇATISË KËNGËTARJA NË FOTO 2 (Emri)					FLORI ANKARA								
	"LITUANIA"					ISLANDA, TAJLANDA			TOKË E BUKËS SHTET DHE KRYEQYTET NË AMERIKË									
	KLUB SPORTIV									INTER TOTO KUVENDI I KOSOVËS			YLLI ME BISHT	AKTORJA ARVANITASE PAPAS	AKTORI I NJOHUR ROBERT DE	EMNAK I EMRIT ENIRA	ZAMBIA, ANGOLA	
PARTNERI, BASHKËPUN- ËTORI											BANOR I KINËS BASHK, TOK							
NIKEL						NIKKI KOKS RUMANIA					AKTORI YNË ARMOND FUTBOLLISTI I KLUBIT MAN. UTD. SAHA							
VARGJE KURANORE	KËNGËTARJA NË FOTO 2 (Mbiemri)	PËRHAPJA E VALËVE	FUQI, FORCË (vjet.) (sh.shq.)	GRUP YNI MUZIKOR (Londër) EDI NONDS						TMERR, TRISHTIM KOPJIMI							APROVIM	
↓								ROBERT ILMUNT TEHERANI						I JASHTËZAKO NSHËM, QË ËSHTË PËRTEJ MASE				
↓							KAMIONI I VOGËL RAST						TONI ADAMS MARC ANTHONY	I SHËMTUAR (vjet.)	ZANORJA E KATËRTË VRULLI, HOVI			
KËNGËTARJA E NJOHUR FOX KORPORATA ENEGJITIKE E KOSOVËS				DEM	"G" në mes të dy "O"	TEFTA TASHKO ARDHJE PAS KOHE NË PUNË			EMËR FEMRE MUSLIMANE LABËRIA						BERNABEU (shk.) BERNA, SIONI			
U ZATETA, U NDESHA								LITRI, TONI ALI ALIU			ALABAMA STADIUMI I KLUBIT MILAN ... SIRO		NGATËRRESË SHKRONJA TË NJËJTA					
FILOZOF DHE MATEMATIKAN GREK									INDIANA, SALZBURGU RAVENA, TRIESTINA				ELEMENT KIMIK (At) TINKA KURTI					
PËREMËR PRONOR				OLIVER NEOVILLE AUSTRALIA			USHTRIA MINESOTA								EMËR I HUAJ FEMRE			
<b>EPOKA ERE</b>	INTENSITET, TANTAL				<b>EPOKA ERE</b>				AKTORJA JONË E VJETËR KURTI						RIMINI (SHK.)			



ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: LEDINA ÇELO, AMPION, ILATITETI, TIMONI, MITETI, ANIMATORET, ADI, MITOTI, LARA, O, NAMATIS, NE, INI, MN, EREMIT, TUZ, JETIMORET, SA, MM, SAZAN, PAT, A, ORA, O, TRA, AR, LI, ARË, KIP, IT, ORTAKU, KINEZ, NI, NK, MORINA, VOËRA, LEMERI, AJETE, RI, MIU, ENORM, SAMANTA, TAMI, TA, I, KEK, TI, ISMA, BER, U TAKOVA, LI, A, BELA, PITAGORA, IS, ASTAT, IME, ON, ARMATA, ENI, ITA, IM, TINKA, RIM.



E rrallë

## la ndërron emrin djalit pas gabimit në tatuazh

Një nënë nga Suedia ka marrë hapa drastikë kur një tatuazh i emrit të djalit të saj Kevin ishte shkruar gabimisht. Për t'u siguruar që tatuazhi i saj ishte i saktë, mamaja (që u bë publike vetëm me emrin Johanna) vendosi ta ndryshojë zyrtarisht emrin e Kevinit në Kelvin. Gabimi është



bërë kur ajo shkoi për t'i bërë tatuazh emrat e fëmijëve Kevinit dhe Novës në krahun e saj.

FOTO E DITES



Një erë fryn mantelin e Papa Françeskut teksa lexon mesazhin e tij gjatë audiencës së përvjetshme javore në Sheshin e Pjetrit në Vatikan. /AP/

E jashtëzakonshme

## E armatosur në diplomim, për një arsye të veçantë

Një vajzë që ka shkuar me pushkë të diplomojë ka shkaktuar një debat të ashpër mbi lirinë personale, protestat e studentëve dhe privilegjin e njerëzve të bardhë. Kaitlin Bennett diplomoi në drejtimin biologji në Universitetin Shtetëror të Kentit në Ohajo. Një ditë pas, 22-vjeçarja u kthye në universitet me një pushkë gjysmautomatike AR-10 të varur në shpinë dhe kapelën e saj të



diplomimit shkruhej: "Eja dhe merre". Ajo ka bërë me dije se me këtë veprim po promovonte të drejtën e saj për ta mbrojtur veten.

## BARSOLETA E DITËS



- Kamerier, ndërroma këtë ushqim!
- Pse?
- Nuk po e pëlqejnë frendsat?
- Ç'thua?
- Ka 10 minuta që e publikova foton në "Facebook" dhe nuk mori asnjë "like".



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 15:00

## "AVENGERS: Infinity War" 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

**Rolet:** Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlett Johansson, Tom Holland, Zoe Saldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

**Regjia:** Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 18:00

## "ISLE OF DOGS"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

**Regjia:** Wes Anderson



Në ora 16:00 dhe 20:00

## "DEADPOOL 2" (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

**Rolet:** Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesy, etj.

**Regjia:** David Leitch

Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, "DEADPOOL 2" do të shfaqet ne ora 13:00 dhe 20:00.




Në ora 22:00

## "I FEEL PRETTY"

Komedi; 1 orë 50 min

**Rolet:** Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

**Regjia:** Abby Kohn & Marc Silverstein



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).




**DASHI**  
Sot do të ndiheni mjaft krenar për

një gjest tuajin dhe nuk do të bëni modesti tek ata persona që do t'ju përgëzojnë pa asnjë rezervë.



**DEMI**  
Do të ngriheni me humor të keq sot

dhe që në orët e para të ditës ata që kanë punë me ju do ta kuptojnë se diçka nuk shkon.



**BINJAKËT**  
Keni dëshirë të merrni pjesë në

shumë aktivitete dhe iniciativa sot, por edhe një ditë e plotë nuk ju mjafton. Duhet të filloni të përzgjidhni.



**GAFORRJA**  
Sot jeni mjaft ambicioz dhe do të

tregoni se dini të luftoni për atë çka mendoni të drejtë si dhe të merrni atë që ju takon me meritë.



**LUANI**  
Jeni shumë protektiv karshi

personave të dashur sot. Mbase duhet të kuptoni se gabimet në jetë mësojnë shumë më tepër se teoritë.



**VIJGJËRESHA**  
Sot nuk do të toleroni me

neglizhenca të tjera lidhur me një projekt tuajin. Jeni munduar t'i mirëkuptoni të tjerët deri më sot, por e kanë marrë si dobësi.



**PESHORJA**  
Sot me durim do të arrini të shmangni

dhe ato situata të pakëndshme që mund t'ju shënojnë ditën. Ndjeni një frymë pesimizmi në ambientin e punës.



**AKREPI**  
Edhe pse ju duket se i keni financat e

sigurta për ca kohë nuk duhet të qëndroni në të njëjtin vend. Keni mundësi të ecni përpara në karrierë.



**SHIGJETARI**  
Sot keni humbur në mendime

dhe nuk shihni se çfarë bëhet rreth jush. Dikush mund të përfitojë nga mosvëmendja juaj.



**BRICJAPI**  
Pak pushim nga rutina do t'ju

ndihmojë të nisni përsëri me këmbë të mbarë. Do të arratiseni në një vend që ju pëlqen shumë.



**UJORI**  
Dihet që sa më lart

kërkon të ngjitesh aq më të mëdha bëhen pengesat. Kjo vlen edhe për rastin tuaj, por nuk do t'ju tremb për të guxuar më shumë.



**PESHQIT**  
Sot edhe një herë do të jeni ju që do

të nxirrni nga situata një person të afërt. Megjithëse të papërgatitur, do të arrini t'ia dilni në një situatë të caktuar.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

MALAGA - GETAFE

2

CHELSEA - MAN UTD

2

RENNES - MONTPELLIER

1

## Vëllaznimi e Gjilani, 'luftë' për t'i ikur barazhit

Vëllaznimi dhe Gjilani pritet të jetë një ndeshje e zjarrtë, pasi të dyja këto skuadra e kanë synim t'i shmangen barazhit. Gjilanit i mjafton barazimi, kurse Vëllaznimit vetëm fitorja. "Gjilani ka një skuadër mjaft të mirë, me lojtarë cilësorë, por të gjithë jemi optimistë se do t'ia dalim ta sigurojmë mbetjen në Superligë, pasi do të luajmë në fushën tonë dhe me ndihmën e tifozëve ky synim nuk është i vështirë për t'u arritur, prandaj Vëllaznimi nuk ka nevojë për barazh", ka thënë Dardan Rogova



edhe barazimi. "Është ndeshja e sezonit për të gjithë neve në klub. Presim një ndeshje të nxehtë në Gjakovë, por nuk kemi arsye të kemi frikë nga Vëllaznimi, sepse jemi më lart se ai dhe presioni nuk është në anën tonë. Atyre duhen tri pikët, kurse neve na mjafton barazimi. Të shohim çfarë do të ndodhë të shtunën", ka thënë Thaqi. Vllaznia e Pozharanit dhe Besa e Pejës kanë rënë nga elita e futbollit të Kosovës, kurse Flamurtari i Prishtinës dhe Gjilani ose

Vëllaznimi do të luajnë në barazh ndaj dy skuadrave të Ligës së Parë.

### Të dielën vendoset titulli dhe përfundon kampionati

Ndeshja më interesante e gjithë këtij kampionati zhvillohet nesër (e diel) në stadiumin "Shahin Haxhiislami" në Pejë. Prishtina, e cila luan në cilësinë e skuadrës vendëse, e pret Dritën e Gjilanit, e

**VALA SUPERLIGA**  
Të shtunën takohen:  
Vëllaznimi - Gjilani  
Drenica - Liria  
Të dielën takohen:  
Prishtina - Drita  
**LIGA E PARË**  
Të shtunën takohen:  
Onix - Dukagjini  
KEK-u - Ramiz Sadiku  
Ballkani - Trepça  
Rahoveci - 2 Korriku  
Bashkimi - Ferizaj  
Kika - Fushë-Kosova  
Hajvalia - Vitia

cila është lidere e klasifikimit. Kryeqytetasve u duhet ta mposhtin skuadrën e Bekim Isufit me një diferencë prej dy golave për të arritur deri te titulli i kampionit, përndryshe Drita rrëmben trofeun e më të mirës. Këto dy skuadra gjatë gjithë edicionit kanë treguar formë të lartë, kurse janë po këto që do ta përfaqësojnë Kosovën në garat ndërkombëtare: Ligën e Kampionëve dhe Ligën e Evropës. Ndeshja fillon nga ora 16:00 dhe është e fundit për edicionin 2017/2018.

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 18 MAJ** - Skuadra që do t'i bashkohet Flamurtarit për ta kërkuar mbetjen në elitë nëpërmjet barazhit vendoset sot (e shtunë), kur do të përballen Vëllaznimi dhe Gjilani. Kjo ndeshje vlerësohet si e dyta për nga rëndësia në xhiron e fundit të elitës së futbollit të Kosovës, pas asaj që e vendos titullin e kampionit në mes të Prishtinës dhe Dritës. Skuadra gjakovare ka dy pikë më pak se skuadra e Gjilanit, por optimizmi në kampin kuqezi është i madh. Dardan Rogova, një prej lojtarëve

më të mirë te Vëllaznimi, ka thënë se skuadra e tij nuk ka nevojë për barazh. "Gjilani ka një skuadër mjaft të mirë, me lojtarë cilësorë, por të gjithë jemi optimistë se do t'ia dalim ta sigurojmë mbetjen në Superligë, pasi do të luajmë në fushën tonë dhe me ndihmën e tifozëve ky synim nuk është i vështirë për t'u arritur, prandaj Vëllaznimi nuk ka nevojë për barazh", ka thënë Rogova për "Epokën e re". Për ndeshjen që zhvillohet të shtunën në Gjakovë ka folur edhe lojtari i Gjilanit, Armend Thaqi. Ky i fundit ka thënë për gazetë se presioni është te skuadra kundërshtarë, pasi Gjilanit i mjafton

## Muçiqi: Nuk ka bileta në shitje

**PRISHTINË, 18 MAJ** - Nënkryetari i Prishtinës, Afrim Muçiqi, ka thënë se janë duke u bërë përpjekjet maksimale me mundësitë që ofron stadiumi, të organizohet sa më mirë që është e mundur ndeshje Prishtina - Drita, e cila përcakton edhe kampionin e ri në futbollin e Kosovës. "Ne kemi vendosur ta respektojmë rregulloren dhe 5 % të kapacitetit dhe 100 ftesa do të jenë falas për tifozët e Dritës. Ne kemi dashur dhe kemi bërë përpjekje maksimale që ndeshjen të organizonim në stadiumin tonë, ku lindja dhe jugu do t'u takonin tifozëve tanë e veriu atyre të Dritës dhe pa pagesë. Por, jemi ku jemi dhe duhet përshtatur stadiumit 'Shahin Haxhiislami'. Bileta nuk do të ketë në shitje. Janë vetëm dy tribuna dhe ajo lindore do të jetë me ftesa vetëm për 'Plisa', kurse ajo mbi zhveshtore



për zyrtarë dhe gazetarë. Tifozëve të Dritës do të provojmë t'ua sigurojmë kushtet adekuate", ka thënë Muçiqi.

Ndërsa përfaqësuesi i Policisë së Kosovës, Bajram Shabani, ka thënë se policia ka marrë të gjitha masat dhe ende është duke e

vlerësuar gjendjen e rrezikshmërisë dhe konform saj do të veprojnë policia e rendit dhe ajo intervenuese apo speciale. "Ne jemi në kontakt të vazhdueshëm me dy tifozët. Do të jemi ata që do t'i përcjellim tifozët nga të dy qytetet dhe, përveç se do të kujdesim për rend, do të kujdesemi edhe për sigurinë e tifozëve dhe mos të vijë as te përplasje eventuale ndërmjet vete. Përndryshe, nuk ka indikacion që do të ketë ndonjë problem, por edhe ne jemi në fazën e vlerësimit të rrezikshmërisë. Unë u bëj apel tërë atyre që do të nisen për Pejë, të jenë korrektë sipas ligjit, sepse edhe ne jemi ata që do të veprojmë sipas ligjeve të Kosovës", ka thënë Shabani. Personi për siguri, Afrim Azemi, ka thënë se me kompaninë e tij private do të ketë numër të mjaftueshëm të personave të sigurimit.

### Gazetarët kërkojnë vend të përshtatshëm për ndeshjen Prishtina - Drita

**PRISHTINË, 18 MAJ** - Shoqata e Gazetarëve Sportivë të Kosovës nëpërmjet një njoftimi për medie i ka bërë apel skuadrës së Prishtinës si organizatore e ndeshjes të mendojë për të improvizuar një tribunë në të cilën do të vendosen gazetarët në mënyrë që të kenë sadopak kushte për ta kryer detyrën e tyre. "Interesimi nga mediet për ta përcjell ndeshjen Prishtina - Drita është shumë i lartë, por meqë stadiumi është në renovim e sipër, kërkojmë nga kolegët gazetarë t'i përmbahen kodit profesional dhe t'i prezantojnë vetëm ata që janë në detyrë", thuhet në njoftimin e ShGSK-së.

## "Shkëndija" e Hajvalisë e mposhti në finale "Emin Durakun"

**PRISHTINË, 18 MAJ** - Ekipi i Shkollës Fillore "Shkëndija" e Hajvalisë e ka mposhtur në finale ekipin e Shkollës Fillore "Emin Duraku" me rezultat 2-1.

Turniri i të gjitha shkollave fillore të Komunës së Prishtinës është organizuar në fushën e Qendrës Sportive "Bujqësia", kurse në vazhdimësi pati edhe

lojërë të mira dhe rivaliteti në mes të lojërave nuk mungoi. "Shkëndija" e Hajvalisë në finale ishte ekip më i mirë se ai i "Emin Durakut", prandaj me meritë e

fitoi epitetin e më të mirës për këtë vit. Kupën ekipit fitues ia dha menaxheri i Qendrës Sportive "Bujqësia", Ismet Ajvazi.



## Guardiola rinovon me Cityn deri në 2021-n

Manchester, 18 maj - Pep Guardiola e ka zgjatur kontratën deri në vitin 2021, duke plotësuar në këtë mënyrë një cikël pesëvjeçar. Spanjoli ka firmosur zyrtarisht kontratën e re që e mban në radhët e kampionëve

të Anglisë edhe për tre vjet të tjera, ashtu siç bëri te Barcelona, por edhe te Bayern Muncheni. "Jam shumë i lumtur dhe entuziazuar që punoj këtu. Kënaqem shumë t'i stërvit këta futbollistë dhe të bëj edhe më mirë në vitet

që do të vijnë. Si menaxher i një skuadre, e rëndësishme është të ndihesh mirë brenda grupit dhe unë ndihem shumë mirë. Çdo ditë punojmë për t'u përmirësuar dhe do të vijojmë në këtë drejtim, duke u përmirësuar në

pushë dhe duke ndihmuar futbollistët tanë të rriten", ka thënë Guardiola, i cili sezonin e ardhshëm do të përfitojë më shumë se 68 milionë euro, duke u bërë trajneri më i paguar në botë.



## Besa dhe Vllaznia, përshëndeten nga Superliga

PRISHTINË, 18 MAJ (ER) - Tri ndeshje të javës së fundit në Vala Superligën e Kosovës në futboll janë zhvilluar të premten, kurse skuadra e Besës së Pejës dhe Vllaznia e Pozharanit janë përshëndetur nga Superliga në mënyrën më të keqe, pasi kanë pësuar humbje nga Llapi, përkatësisht Trepça '89. Besa humbi me rezultat 3-4 nga Llapi dhe në këtë mënyrë për herë të parë në historinë e saj largohet nga elita. Për skuadrën e Llapit nga dy gola i shënuan Gentrin Begolli dhe Mirlind Daku, kurse për Besën golat i shënuan Fetim Kasapi dy, dhe një tjetër Florent Qorraj. Ekipi pejan nga minuta e 53-të luajti me një lojtar më pak, pasi nga loja u përjashtua Florent Papuqi.

Në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Riza Lushta" janë shënuar shtatë gola. Ishte skuadra vendëse, Trepça '89, që i la një shije të keqe



skuadrës së Vllaznisë nga Pozhrani, pasi e ka mposhtur me rezultat 6-1, në ndeshjen e saj të fundit në Superligë. Golat për 89-shin i shënuan Mohammad El-Kayed (2), Ylber Maloku (18, 64), Elbasan Thaqi (47'), Otto John (54) nga penalltia, Arb Manaj (66), kurse golin e nderit për mysafirët e shënoi Almedin Murati

(83). Në ndeshjen e tretë Feronikeli e mposhti Flamurtarin në kryeqytet me rezultat 0-3.

### REZULTATET

Trepça '89 - Vllaznia	6-1
Besa - Llapi	1-4
Flamurtari - Feronikeli	0-3

## Platini zbulon kurdisjen në 'Francë '98'

PARIS, 18 MAJ - Michel Platini ka zbuluar atë që e quan "hile" në momentin e shortit të Kupës së Botës 1998 për të pasur sa më shumë shanse që Franca të mos ndeshet me Brazilin deri në finale. Veprimtaria që u zhvillua në Francë u fitua nga "gjelat", në suksesin e tyre të parë dhe të vetëm në një Botëror, pikërisht duke mundur Brazilin 3-0 në finale. Ish-presidenti i UEFA-s pohoi se francezët u ndihmuan edhe nga shorti. "Kur organizuam kalendarin në bëmë një hile. Nëse



ne do të fitonim grupin tonë dhe Brazilin do ta fitonte grupin e tij, atëherë nuk do të ndesheshim bashkë deri në finale", ka thënë Platini për "France Bleu Sport". Franca ra në Grupin C, ndërsa

Brazilin në Grupin A dhe në momentin që të dyja ekipet dolën në vendin e parë, plani i vendësve u quajt i suksesshëm.

Platini, që ishte kryetari i komitetit organizativ të atij botërori, shtoi: "Punuam gjashtë vjet për të organizuar këtë veprimtari dhe normalisht përdorëm këtë hile të vogël. Mendoni se vendet e tjera organizatore nuk e kanë bërë në të kaluarën? Francë - Brazil ishte finalja që të gjithë donim. Realizuar një ëndërr".

## Federata Skitare e Kosovës pranohet me të drejta të plota në FIS

PRISHTINË, 18 MAJ - Federata Skitare e Kosovës (FSK) është bërë anëtare me të drejta të plota e Federatës Ndërkombëtare të Skitarisë (FIS). Vendimi është marrë të premten në Kongresin e 51-të të FIS-it që po mbahet në Costa Navarino të Greqisë.

Presidenti i FSK-së, Milaim Kelmendi, ka thënë se vendimi për pranimin e FIS-it është marrë unanimisht. "Në Kongresin e 51-të të Federatës Ndërkombëtare të Skijimit, FSK-ja dhe shteti i Republikës së Kosovës jemi pranuar si anëtarë me të drejta të plota në familjen e madhe të FIS-it. Ky



është një hap para në qëllimin tonë të përbashkët për zhvillimin e sportit të skijimit në Republikën e Kosovës, po ashtu në të njëjtën

kohë siguron edhe ofrimin e barabartë të mundësive për zhvillimin e skijimit në shtetin tonë", ka thënë Kelmendi.

### SHKURT

#### Prishtina i bashkohet Besës në finale

Prishtina ka kaluar në finale të "play-off"-it të kampionatit të Kosovës në hendboll, pasi e ka mposhtur Kastriotin në Ferizaj me rezultat 35:31. Në finale skuadra kryeqytetase do të luajë ndaj Besa FamGas. Ishte kjo fitorja e dytë treshit e Prishtinës në gjysmëfinalen e "play-off"-it ndaj Kastriotit. Të shtunën e kaluar në kryeqytet prishtinasit fituan me rezultat 31:24. Ndërsa fitorja e dytë ishte pak më e ngushtë, por e mjaftueshme për kalimin në finale. Pas pjesës së parë rezultati ishte 18:14 në të mirë të Prishtinës. Finalja nis pas një jave, të mërkurën ose të enjten e ardhshme. Ndeshja e parë luhet në Pejë.

#### Casillasi edhe një vit te Porto

Ish-portieri i Real Madridit, Iker Casillas, e ka vazhduar kontratën me skuadrën e Portos. Lajmin për vazhdimin e kontratës edhe për një vit tjetër e ka bërë zyrtar klubi portugez. Ndërsa mediet kanë raportuar se portieri spanjoll ka pranuar një ulje të pagës për ta vazhduar aventurën me Porton, ekip me të cilin u shpall kampion i Portugalisë.

#### Dovizioso vazhdon me Ducatin deri më 2020

Andrea Dovizioso ka arritur marrëveshjen me Ducatin për zgjatjen e marrëveshjes deri në vitin 2020. Mungon vetëm zyrtarizimi, por është e sigurt se Dovi do të garojë edhe për dy vjet të tjera mbi Desmosedicin e skuadrës zyrtare, duke vijuar kështu bashkëpunimin e nisur që në vitin 2013. Në pesë sezone me Ducatin, piloti italian ka fituar tetë gara dhe ka arritur të ngjitet në podium edhe në 13 raste të tjera, duke iu afruar shumë pranë titullit kampion bote në vitin 2017.

#### Oweni nuk e sheh Anglinë favorite në "Rusi 2018"

Ish-sulmuesi i Liverpoolit, Real Madridit dhe Kombëtares së Anglisë, Michael Owen, nuk e sheh skuadrën e "Tre Luanëve" favorit për ta fituar Kupën e Botës "Rusi 2018". "Nuk kam shumë besim tek Anglia, por kam shpresë. Mendoj se nuk kemi një ekip të fortë si në vitet e kaluar dhe ende nuk e dimë se cili do të jetë portieri titullar. Garancia e vetme janë golat e Kanes. Gjithsesi kemi pasur shumë dëmtime në mesfushë dhe kjo më shqetëson. Shorti na ka favorizuar në fazën me grupe dhe mendoj se do të shkojmë deri në çerekfinale, sepse nuk do të kemi kundërshtarë të fortë. Nuk besoj se mund të fitojmë ndaj Brazilit, Spanjës, Francës ose Gjermanisë", ka thënë Oweni, i cili në karrierën e tij ka regjistruar 89 ndeshje dhe ka shënuar 40 gola.

#### Aguero: Kam pasur mundësi të luaj me Messin

Sergio Aguero ka konfirmuar se nuk do të largohet nga Manchester City ani pse mediet në kohët e fundit e kanë lidhur me një transferim te Barcelona ose ish-skuadra e tij, Atletico Madrid. "Në të kaluarën kam pasur mundësinë të luaj me Messin te Barcelona, por tani kjo mundësi ka përduruar sepse unë e refuzova. Ndoshta nuk do të jemi kurrë shok në klube, kjo edhe prej moshës sonë dhe prej vendimit tim për të qëndruar te Manchester City. As që më shkon në mend të largohem dhe do të bëj të pamundurën për ta fituar Ligën e Kampionëve me këtë skuadër që më ka dhënë gjithçka për të cilën ka nevojë një futbollist", ka deklaruar Aguero, i cili foli edhe për Kupën e Botës "Rusi 2018": "Mendoj se do të luaj dhe do të paraqitem mirë sepse kjo është hera e parë në pesë vjetet e fundit që mund të fërkoj gjurin tim dhe të mos ndiej dhimbje".



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Duke u bazuar në dispozitat e ligjit me nr.04/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, nenit 20 paragrafi 1 të ligjit me nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 5 paragrafi 1 shkronja d, të ligjit me nr.03/L-068 për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës si dhe dispozitave të Udhëzimit Administrativ me nr.08/2014 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendës drejtorit nëpër shkollë, Drejtoria e Arsimit-Komuna e Prizrenit, shpall:

## KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Nr. 01-111-72292

Datë: 18.05.2018

Drejtoria e Arsimit

Titulli i vendit të punës : Drejtor i Shkollës Fillore  
në:

- SHFMU "Fatmir Berisha" - Prizren
- SHFMU "Xhevat Berisha" - Prizren
- SHFMU "Fadil Hisari" - Prizren
- SHFMU "Mati Logoreci" - Prizren
- SHFMU "Ibrahim Fehmiu" - Prizren
- SHFMU "Zef Lush Marku" - Velezhë, Komuna e Prizrenit
- SHFMU "22 Dëshmorët" - Randobravë, Komuna e Prizrenit
- SHFMU "Dëshmorët e Kabashit" - Korishë, Komuna e Prizrenit
- SHFMU "Shtjefën Gjeqovi" - Zym, Komuna e Prizrenit
- SHFMU "Nazim Buduri" - Hoqë e Qytetit, Komuna e Prizrenit
- SHFMU "Sharr" - Jabllanicë, Komuna e Prizrenit
- SHFMU "Pjetër Mazreku" - Mazrek, Komuna e Prizrenit
- SHFMU "Hasim Maliqaj" - Poslisht, Komuna e Prizrenit
- SHFMU "Krushë e Vogël" - Krushë e Vogël, Komuna e Prizrenit
- SHFMU "Abdyl Frashëri" - Prizren
- SHFMU "Lekë Dugagjini" - Prizren

**Pozita:** Jo karrierës  
**Numri i Pozitave :** gjashtëmbëdhjetë (16) pozita  
**Kategoria Funktionale:** Niveli drejtues 1  
**Grada e vendit të punës:** 7  
**Koeficienti:** 7.8  
**Kohëzgjatja e emërimit:** Katër (4) vjet

### Qëllimi i vendit të punës:

Zhvillimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të politikave dhe procedurave standarde dhe ofrimi i shërbimeve arsimore në shkollë.

### Detvat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Menaxhon punën e përgjithshme të shkollës, përgatit planin zhvillimor të shkollës, cakton objektivat dhe zhvillimin e planit të punës për përbushjen e këtyre objektivave; 20%
- Menaxhon stafin e shkollës, dhe në bashkëpunim me DKA-në, organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek stafi nën mbikëqyrje, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të ofruar shërbime cilësore; 15%
- Vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme dhe rekomandon ndryshime / përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë në arsim; 10%
- Menaxhon me financat e shkollës dhe bashkëpunon me këshillin drejtues të shkollës për menaxhim sa më efikas të buxhetit financiar; 10%
- Zhvillon dhe propozon politika në lidhje me organizimin e procesit mësimor, kujdeset për mirëqenien dhe sigurinë e të gjithëve në shkollë, përfshirjen dhe vijimin e nxënësve në shkollë, inicimin e procedurave disiplinore ndaj stafit nën mbikëqyrje dhe nxënësve në përputhje me dispozitat ligjore; 15%
- Drejtori është i obliguar të paraqes raport vjetor për veprimtarinë e shkollës dhe të jep informacione të tilla sa herë që kërkohet nga DKA dhe MASHT-i, i raporton këshillit drejtues të shkollës, sipas kërkesës, për financat dhe aktivitetet e tjera të shkollës, 10%
- Koordinon punën dhe bashkëpunon me Këshillin e Shkollës, organet tjera shkollore dhe institucionet tjera; 10%
- Bënë vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij/saj dhe përkrah zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre në përputhje me standardet e kërkuara. 5%
- Kryen detyra të tjera të caktuara nga DKA, MASHT në bazë të ligjeve dhe akteve nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës. 5%

### Shkathtësitë e kërkuara:

- Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim,
- Njohuri dhe përvojë në fushën arsimi,
- Shkathtësi në caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë,
- Shkathtësi në udhëheqje dhe organizim të ekipit, aftësi për të menaxhuar një ekip ose grup punues,
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access),
- Njohuri të gjuhëve zyrtare,
- Shkathtësi zhvillimi, implementimi dhe monitorimi të politikave të Burimeve Njerëzore,
- Njohuri strategjike dhe procedurale,
- Shkathtësi komunikimi, prezantimi, këshillimi,
- Të jap solucione të reja dhe praktike në lidhje me problemet dhe nevojat e shkollës,
- Fleksibiliteti dhe aftësi për tu përballur me rrethanat e reja;

### Kushtet :

- Të jenë Shtetas të Republikës së Kosovës
- Të ketë së paku arsimimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) nga profilit e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas Udhëzimit të licencimit e mësimdhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore
- Së paku 3 vite përvojë pune në arsim ose në institucione të arsimit
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedurë të licencimit

- Të kenë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim

### Dokumentet e domosdoshme:

- Certifikatën e lindjes
- Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës
- Dëshminë për përvojën e punës
- Portofolion profesionale
- Letër referencë nga një institucion publik- kredibil (si ministria e arsimit, shkencës dhe e teknologjisë, DKA, Këshilli Drejtues i shkollës, punëdhënësi paraparak institucionet e arsimit të lartë)
- Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet
- Planin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësuese për të cilin ka konkuruar (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12, Arial) sipas Udhëzimeve të MASHT
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore (për arsye të minimizimit të shpenzimeve të kandidatëve kërkohet në fund të procedurës së rekrutimit vetëm nga kandidatit më i suksesshëm)

**Konkursi ngel i hapur 15 ditë kalendrike** nga dita e publikimit, duke filluar nga data e publikimit më 18.05.2018 deri më datën 01.06.2018 që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

**Instrukione Aplikimi:** Kërkesa (Aplikacioni) për punësim gjendet në <https://kk.rks-gov.net/prizren/category/konkursct-njoftimct/aplikacione/>, dhe pas plotësimit sipas çdo pike të aplikacionit, i bashkangjiti dokumentet të cilat kërkohen sipas konkursit dhe mund të aplikoni tek ne drejtëpërdrejt - Adresa jonë: në sportelin e pranimit nr. 2, në objektin e administratës komunale në Komunën e Prizrenit, rr. "Remzi Ademaj" p.n. -Prizren.

**VËMENDJE:** Njoftimet i gjeni në Ueb, ndërsa në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038 / 200 44715 prej orës 08:00 – 16:00. Aplikacionet e pranuar pas afatit të përcaktuar konsiderohen të pranueshme, nëse data në dërgesën postare, ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar para kalimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve. Kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kushtet nuk ftohen në test me shkrim, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen me shkrim (e-mail) në rast të mos konfirmimit të kandidatit në e-mail do të njoftohet me telefon dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para komisionit, në rast të mos sjelljes të dokumentacionit origjinal intervistues, kandidatët nuk do të mund të vazhdojnë në hapat e mëtejshëm të procedurave të rekrutimit.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Komuna e Prizrenit

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Horn&Co. Kosova" Sh.p.k. Lebush Deçan, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:


## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për qendrën grumbulluese dhe deponuese të tullave zjarrduruese mbeturinë në Lebushë komuna e Deçanit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 14.06.2018. në ora 11:00 në hapësirat e Restorant "Iliria" në Deçan, do të organizohet debat publik nga Kompania "Horn&Co. Kosova" Sh.p.k. Lebushë Deçan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për qendrën grumbulluese dhe deponuese të tullave zjarrduruese mbeturinë në Lebushë komuna e Deçanit.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Drejtoria Komonale e Arsimit  
Odeljenje za Obrazovanje  
Department of Education

Në bazë të nenit 66.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr.03/L-40, neni 6 të Statutit të Komunës, Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ të MASHT-it nr.08/2014 të datës 25.02.2014, Drejtoria Komonale e Arsimit në Rahovec shpall:

### KONKURS

I- Për zgjedhjen e drejtorëve të SHFMU dhe SHML të komunës së Rahovecit

- 1) Një drejtor për SHFMU "Vëllezërit Frashëri" në Drenoc
- 2) Një drejtor për SHFMU "Heronjtë e Kosovës" në Hoçë e Vogël-Brestoc
- 3) Një drejtor për SHFMU "Tre Dëshmorët" në Vrajak-Bratotin
- 4) Një drejtor për SHFMU "Skënder Kastrati" në Radoste
- 5) Një drejtor në SHFMU "7 Shtatori" në Rahovec
- 6) Një drejtor në SHFMU "Bajram Curri" në Krushë të Madhe
- 7) Një drejtor në SHFMU "Sylejman Vokshi" në Polluzhë
- 8) Një drejtor në SHFMU "Mustaf Ibishi" në Kramovik
- 9) Një drejtor në SHML "Xhelal Hajda-Toni" në Rahovec
- 10) Një drejtor në SHML "12 Maji" në Ratkoc

Kushtet për konkurim:

1. Të gjithë kandidatët e interesuar për konkurim në vendet e punës për drejtor shkolle duhet t'i plotësojnë këto kushte:
  - 1.1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës
  - 1.2. Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas Udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe Normativit mbi punësimin e kuadrit të mësimdhënësve dhe rregullativës tjetër ligjore.
  - 1.3. Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedurë të licencimit.
2. Të kenë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim e menaxhim.
3. Të kenë së paku 3 vite përvojë pune në arsim ose në institucione arsimore.
4. Kandidatët konkurent duhet të posedojnë këto dokumente:
  - 4.1. Ekstraktin e lindjes
  - 4.2. Diploma e fakultetit të kryer për nivelin përkatës
  - 4.3. Dëshminë për përvojën e punës
  - 4.4. Portfolijen profesionale (shihni shtojcën "G" të U A 08/2014)
  - 4.5. Letër referencë nga një institucion publik kredibil (si MASHT-i, DKA, Këshilli drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë)
  - 4.6. Letër referencë, e cila duhet të ketë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake.
  - 4.7. Planin zhvillimor të institucionit edukativ arsimor dhe aftësues për të cilin ka konkuruar (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12)
  - 4.8. Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor.
  - 4.9. Dëshminë që dëshmon që kandidati/ia nuk është nën hetime.

Detyrat e punës:


Detyrat e punës së drejtorit të shkollës janë të përcaktuara në rregulloret për organizimin e punës dhe të mësimin në shkolla.

Kohëzgjatja: Marrëdhënia e punës lidhet përmes kontratës, në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligjin për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës dhe zgjat 4 (katër) vite, duke përfshirë edhe periudhën tremujore provuese.

Aplikacionet për konkurim merren në DKA dhe dokumentet dorëzohen po aty.

Afati i konkurimit është 15 ditë nga dita e shpalljes të konkursit.

RAHOVEC  
18.05.2018



Drejtoria Komonale e Arsimit  
Opštinsko Odeljenje za Obrazovanje  
Municipal Department of Education

Na osnovu člana 66.1 Zakona za Lokalnu Samoupravu Kosova Br. 03/L-040, člana 6. Statuta Opštine, Zakona za Obrazovanje u Opštinama Republike Kosova i Administrativnog Uputstva M.O.N.T –a br. 08/2014 od 25.02.2014. g, Opštinsko Odeljenje za Obrazovanje u Orahovcu objavljuje.

### KONKURS

I - Za izbor direktora S.N.O.Š i V.S.Š opštine Orahovec,

- 1) Jedan direktor u S.N.O.Š „Vëllezërit Frashëri” u Drenovac,
- 2) Jedan direktor u S.N.O.Š „Heronjtë e Kosovës” u Maloj Hoçi – Brestovac,
- 3) Jedan direktor u S.N.O.Š „Tre Dëshmorët” u Vranjak / Bratotin,
- 4) Jedan direktor u S.N.O.Š „Skënder Kastrati” u Radoste
- 5) Jedan direktor u S.N.O.Š “7 Shtatori” u Orahovcu
- 6) Jedan direktor u S.N.O.Š “Bajram Curri” u Velikoj Kruši
- 7) Jedan direktor u S.N.O.Š “Sylejman Vokshi” u Poluže
- 8) Jedan direktor u S.N.O.Š “Mustaf Ibishi” u Kramovik
- 9) Jedan direktor u V.S.Š “Xhelal Hajda-Toni” u Orahovcu
- 10) Jedan direktor u V.S.Š “12 Maji” u Ratkoc

Uslovi dostave aplikacije:

1. Svi zainteresovani kandidati koji žele da dostave aplikacije na radnom mestu za direktora škole treba da ispune uslove, i to:
  - 1.1. Da budu državljanin Republike Kosova,
  - 1.2. Da imaju završeno najmanje univerzitetsko obrazovanje početnog nivoa (najmanja kvalifikacija od 240 ECTS/4. godine univerzitetskog obrazovanja) prihvatljivih profila za položaj nastavnika na osnovu Uputstva za licenciranje nastavnika i Odredbama o zapošljavanju osoblja obrazovanja i drugim zakonskim regulativama.
  - 1.3. Da imaju važeću licencu nastavnika kao i oni koji su u toku procesa licenciranja.
2. Da imaju uspešno završeno akreditirani program stručne kvalifikacije za rukovođenje, administraciju ili menadžiranje.
3. Da imaju najmanje 3. godine radnog iskustva u obrazovanju ili institucijama obrazovanja.
3. Kandidati koji dostave aplikaciju treba da imaju ove dokumente:
  - 4.1 Ekstrakt rođenja,
  - 4.2 Diploma završenog fakulteta dotičnog nivoa,
  - 4.3 Dokaz radnog iskustva,
  - 4.4 CV (vidi dodatak „G“ A.U 08/2014)
  - 4.5 Referenca javne verodostojne institucije (kao M.O.N.T, O.O.O, Upravni Odbor Škole, prethodni poslodavac, visoke institucije obrazovanja),
  - 4.6 Referenca, koja treba da ima dovoljno dokaza o prethodnom radu i angažovanju,
  - 4.7 Razvojni plan institucije obrazovanja i obuke za koju je dostavio aplikaciju (najmanje 10 lista teksta sa među prostorom 1.5, font slova 12),
  - 4.8 Lekarsko uverenje izdato od javne zdravstvene institucije,
  - 4.9 Dokaz koji dokazuje da kandidat/kinja nije pod istragom.

Radne dužnosti:

Radne dužnosti direktora škole određene su pravilnikom za organizovanje rada i nastave u školi.

Rok trajanja: Radni odnos sklapa se ugovorom, u skladu sa Zakonom Civilne Službe Kosova, Zakonom za Obrazovanje u Opštinama Republike Kosova, i traje 4. (četiri) godine, uključujući i tromesečni probni period.

Aplikacije za konkurs možete uzeti i dostaviti u Odeljenju za Obrazovanje.

Rok dostave aplikacija traje 15. dana od dana objave konkursa.

ORAOVAC  
18.05.2018





MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/ DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES/ DEPARTMANI I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVISION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, L. nr. 03/L-149, dhe Rregulloren nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

## KONKURS

**Titulli i punës:** Zyrtar Multimedial

**Kategoria funksionale/ Koeficienti** 7

**Numri i referencës:** 27/2018

**I përgjigjet:** Udhëheqësit të Divizionit për Komunikim me Publikun

**Vendi:** Prishtinë

**Lloji i kontratës:** "Marrëveshje për shërbime të veçanta" (kohëzgjatje 6 muaj)

**Detyrat dhe përgjegjësitë:** Nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të Divizionit për Teknologji

Informative kryen detyra dhe përgjegjësitë:

### Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet me udhëheqësin e Zyrës dhe stafin tjetër profesional për zbatimin e shërbimeve dhe produkteve përkatëse;
- Kryen detyra të specializuara, sipas kërkesës, në fushën profesionale në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
- Bënë fotografimin dhe editimin e tyre për media;
- Kryen detyrat në fushën profesionale specifike me një shkallë të arsyeshme të pavarësisë, me mbikëqyrje dhe udhëzime të kohëpaskohshme;
- Përgatitë - dizajnon raportin vjetor, raporte apo informacione tjera të MKRS-së;
- Merr pjesë në grupe punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet një gjë e tillë;
- Komunikon brenda institucionit dhe jashtë tij për shkëmbim të informatave dhe zhvillimin e punës në fushat e interesit të përbashkët.
- Raporton rregullisht të mbikëqyrësi rreth progresit në lidhje me planet e punës të miratuara;
- Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe (përpunimin e videove dhe arkivimin e tyre, krijimin e spoteve promovuese për MKRS-në, dhe punë tjera).

### Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Njohuri të thellë në fushën profesionale specifike multimediale;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës koordinim eventual të personelit në nivel administrativ;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Adobe Premier Pro, Adobe photo shop, Adobe After Effect, Adobe Audition, Adobe In Desing, Adobe Illustrator);
- Diplomë universitare, pa përvje pune, ose shkolla e mesme me 2 vite përvje pune.

### Procedurat e konkurrimit:

Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët.

**Kohëzgjatja e emërimit:** Emërimi është me afat të caktuar.

**Data e mbylljes së konkursit:** Konkursi është i hapur tete (8) ditë pas ditës së shpalljes.

**Data e fundit e aplikimit është:** 26.05.2018

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacioni merret dhe dorëzohet në zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Terezë" nr. 35. Për informata shtesë kontakti në numrin 038211449 (apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>).



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/ DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES/ DEPARTMANI I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVISION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazirajući se na Zakon o Civilnim Uslugama Republike Kosova, Z. br. 03/L-149, Pravilnik br. 02/2010, o Procedurama za Rekrutovanje u Civilnim Uslugama Republike Kosova, Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta objavljuje:

## KONKURS

**Naziv rada:** Multimedialni zvaničnik

**Funkcionalna Kategorija/ Koeficientat** 7

**Broj referencije:** 27/2018

**Odgovorjanje:** Rukovodiocu Divizije za Komuniciranje sa Javnošću

**Mesto:** Priština

**Vrsta ugovora:** "Sporazum o posebnim uslugama" (vremensko trajanje 6 meseci)

**Zadaci i odgovornosti:** Pod nadzorom rukovodioca Divizije za Informativnu Tehnologiju, izvršava sledeće zadatke i odgovornosti:

### Zadaci i odgovornosti:

- Razvija i postiže saglasnost o planovima rada i rokovima sa rukovodiocem kancelarije i ostalim profesionalnim stafom za sprovođenje dotičnih usluga i proizvoda;
- Izvršava specializovane zadatke, prema zahtevu, iz profesionalne oblasti u podudarnosti sa dotičnim zakonom, pravilnicima, politikama i procedurama, unitar određenih vremenskih rokova;
- Vršiti slikanje i njihovo predstavljanje u medijima;
- Izvršava zadatke iz specifične profesionalne oblasti, sa razložnim stepenom nezavisnosti, sa povremenim nadziranjima i uputstvima;
- Priprema – dizajnira godišnji izveštaj, ostale izveštaje ili informacije o MKOS-u;
- Učestvuje u radnim grupama iz specifične, profesionalne oblasti, kada se tako neto zahteva;
- Komunicira unitar institucije i van nje o razmeni informacija i razvoju delatnosti, u oblastima zajedničkog interesa.
- Redovno izveštava nadzorniku oko progressa i u vezi prihvaćenih planova rada;
- Izvršava vaki drugi zadatak iz specifične profesionalne oblasti, koji se mogu, na razložan način, zahtevati s vremena na vreme (prerađivanje video-a i njihovo arhiviranje, uređivanje spotova za promovisanje MKOS-a i ostale delatnosti).

### Kvalifikovanje, radno iskustvo i sposobnosti:

- Duboko znanje specifične profesionalne multimedijске oblasti;
- Znanje sprovodljivih zakona i pravilnika;
- Sposobnost u komuniciranju, planiranju rada, eventualnom koordiniranju osoblja na administrativnom nivou;
- Sposobnost istraživanja, analize, procenijavanja i formulisanja profesionalnih preporuka i saveta;
- Sposobnost na kompjuteru za aplikovanje programa (Word, Excel, Power Point, Access, Adobe Premier Pro, Adobe photo shop, Adobe After Effect, Adobe Audition, Adobe In Desing, Adobe Illustrator);
- Univerzitetaska Diploma, bez radnog iskustva ili srednja škola sa 2 godine radnog iskustva.

### Procedura konkurisanja:

Konkurs je otvoren za sve kandidate.

**Vremensko trajanje imenovanja:** Imenovanje je na određenovreme.

**Datum zatvaranja konkursa:** Konkurs je otvoren osam (8) dana, nakon dana objavljivanja.

**Zadni datum za aplikovanje je:** 26.05.2018

Aplikacije poslate preko pošte, sa poštanskom markom, na zadnji dan objave, smatraće se validnim.

**Podnošenje zahteva:** Aplikacija se uzima i predaje u kancelariji br. 27 u Ministarstvu Kulture, Omladine i Sporta, Trg "Majka Tereza" br. 35. Za dodatne informacije, kontaktirajte broj 038211449 (ili web-stranicu <http://www.mkrs-ks.org/>).

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Haxha Comapany" Sh.p.k Llaushë, Skenderaj, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e gurit gëlqeror (zgjerim i fushës shfrytëzuese) zona kadastrale Tërllabuç dhe Karaçë komuna e Vushtrisë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 13.06. 2018. në ora 11: 00 në hapësirat e Hotel "Kalaj" rruga Istref Rexhep Haziri p.nr. afër rrugës magjistrale Prishtinë – Mitrovicë, në Vushtrri, do të organizohet debat publik nga Kompania "Haxha Comapany" Sh.p.k Llaushë, Skenderaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e gurit gëlqeror (zgjerim i fushës shfrytëzuese) zona kadastrale Tërllabuç dhe Karaçë komuna e Vushtrisë.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

C.nr.374/15

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil.** Gjyqtari Liridon Maloku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Isuf (Beqir) Saraçi nga fshati Glllovotin, Komuna e Vushtrisë, kundër të paditurve Stojan Ristic dhe Vojislav Ristic nga ish fshati Glllovotin, Komuna e Vushtrisë, tani me vendbanim të panjohur, për shkak të çështjes juridike, vërtetim pronësie në bazë të shitblerjes dhe mbajtjes, më datën **30.04.2018** nxjerr këtë:

### AKTVENDIM

- I. **CAKTOHET** përfaqësues i përkohshëm avokati Namon Merovci nga Vushtrria, për t'i ushtruar të gjitha të drejtat dhe detyrat për të paditurit Stojan Ristic dhe Vojislav Ristic, derisa të paraqiten në gjykatë të paditurit apo përfaqësuesi i tyre me prokurë.
- II. Përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha autorizimet në këtë çështje, për të ndërmarr të gjitha veprimet juridike për mbrojtjen e interesave të të paditurve, deri në momentin kur të paditurit të paraqitet personalisht në gjykatë apo të caktojë të autorizuarin e tyre.
- III. Shpenzimet për përfaqësuesin e përkohshëm i bartë pala paditëse.
- IV. Seanca e radhës për shqyrtim gjyqësor caktohet me datën 12/06/2018 në ora 09.00, ky komunikim palëve ndërgjyqësve ju shërben në vend të thirrjes së rregullt.
- V. Ky aktvendim do të publikohet në mjetet e informimit publik, tabelën e shpalljes së kësaj Gjykate dhe Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, po ashtu i dorëzohet paditësit dhe përfaqësuesit të përkohshëm të paditurve si dhe Organit të Kujdestarisë.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË DEGA NË VUSHTRRI,**  
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Civil  
C.nr.374/15 e datës 30.04.2018



**KËSHILLË JURIDIKE:** Në bazë të nenit 387 paragrafi 1 PK-së, kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar e drejta në ankesë.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Florian Lushaj shpall te pa vlefshme dëftesat e viteve X,XI,XII, diplomën dhe Certifikatën e Gjinnazit "Hajdar Dushi" në Gjakovë.

► Adea Haxhidauti shpall te pa vlefshme dëftesat e viteve X,XI,XII dhe diplomën e Gjinnazit "Hajdar Dushi" në Gjakovë.

► Ardit Gillogjani shpall te pa vlefshme Certifikatën e përfundimit të Sh.M. Gjinnazit "Hajdar Dushi" në Gjakovë.

Mirsada Xhaferi shpall te pavlefshme diplomën shpallim "Luciano Motroni" Prizren.

► Qendrim Gegollaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf "Pjeter Budi" Lubizhd e Hasit.

► Fildane Rexhepi shpall te pavlefshem ID Vu E-16/18 Kolegji i Biznesit dega ne Vushtrri.

► Visar Hyseni fton bashkëpronaret qe janë te interesuar për blerjen nr parcelës kadastrale P-70202016- 03626 K0 ZK Vushtrria qe te lajmërohen te shitësi Visar Hyseni rruga Bahri Kuqi Vushtrri.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektesë si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

RESTAURANT

**SWISS**  
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

Prishtinë



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/giejpuneshpeite



## AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperienca jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Afati i paraqitjes prej 03.03.2018  
deri më 10.03.2018**

**Ju mirëpret:**

**Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**